FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 77

Tiranë – E hënë, 9 maj 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 38/2016 datë 14.4.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".....	4405
Ligj nr. 39/2016 datë 14.4.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, "Për sigurimin e depozitave".....	4405
Ligj nr. 40/2016 datë 14.4.2016	Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë.....	4407
Ligj nr. 41/2016 datë 14.4.2016	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen për Ngritjen e Qendrës së Ekselencës në Financë (CEF), bërë në Bled, më 3.9.2013.....	4413
Ligj nr. 42/2016 datë 14.4.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për Mbrojtjen Shoqërore.....	4421
Ligj nr. 44/2016 datë 21.4.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar.....	4430
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 6.4.2016	Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit".....	4434

LIGJ
Nr. 38/2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

Në mbështetje të neneve 6/1, 81, pikat 1 dhe 2 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 1 dhe 2, fjalët "Për personat që parashikohen" zëvendësohen me fjalët "Për personat e dënuar për veprat penale që parashikohen";

2. Në pikat 3 dhe 4, fjalët "Për personat që parashikohen" zëvendësohen me fjalët "Për personat e dënuar për kryerjen e një krimi që parashikohet";

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Për personat e dëbuar sipas parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, kohëzgjatja e ndalimit për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit është:

i) përjetë për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 1, shkronja "a";

ii) 20 vjet për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 1, shkronja "b";

iii) 10 vjet për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 1, shkronja "c", pavarësisht uljes së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit.".

Neni 2

Në nenin 5, pika 4, shkronjat "d", "dh", " e", "ë" dhe "f" riformulohen si më poshtë:

"d) pranë titullarit apo organit që bën emërimin për funksionarin publik që emërohet sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 3 dhe kur ky emërim është i ndryshëm nga funksionet e zgjedhura me votim nga Kuvendi, si dhe kur emërimi bëhet sipas shkronjave "d" dhe "g", të pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji;

dh) pranë Kryeministrit, për rastet e parashikuara nga shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji;

e) pranë Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror apo Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, sipas rastit, për shkronjat "dh" dhe "ë", të pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji;

ë) pranë Departamentit të Administratës Publike, për rastet e parashikuara nga shkronja "e", e pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji;

f) pranë Ministrit të Mbrojtjes, për rastet e parashikuara në shkronjën "f", të pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji.".

Neni 3

Në nenin 12, pika 1, pas fjalëve "shkronjat "a" dhe "b"" shtohen fjalët "të pikës 1".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.4.2016

Shpallur me dekretin nr. 9549, datë 3.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 39/2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 53/2014, "PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE"[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën 2014/49/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 prill 2014, "Mbi skemat e garantimit të depozitave", Numri CELEX: 32014L0049, Fletorja Zyrtare e BE-së, Seria L, Nr. 173, datë 12.6.2014, faqe 149-178.*

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 53/2014, "Për sigurimin e depozitave", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, "Përkufizime", bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 13, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) çdo shumë parash që anëtari, depozituesi i shoqërisë së kursim-kreditit depoziton pranë saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë e kursim-kreditit.".

2. Pika 17 ndryshohet si më poshtë:

"17. "Depozitues" është çdo person fizik, tregtar dhe shoqëri tregtare, të cilët kanë të drejtën e përfitimit të pagesës së një depozite nga një subjekt, anëtar i skemës së sigurimit të depozitave, përfshirë këtu titullarin me të drejta të plota të një depozite në bashkëpronësi dhe çdo përfitues të një depozite të palës së tretë.".

3. Pas pikës 31 shtohen pikat 32, 33 dhe 34 me këtë përmbajtje:

"32. "Person fizik" ka kuptimin e përcaktuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, të ndryshuar.

33. "Tregtar" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

34. "Shoqëri tregtare" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.".

Neni 2

Në nenin 26, "Regjistri elektronik i detyrimeve depozitë të subjektit" pika 5, ndryshohet si më poshtë:

"5. Funksioni kryesor që përmbush sistemi elektronik i Agjencisë është identifikimi i depozituesit me një numër unik në sistem, i cili përputhet me të dhënat personale të depozituesit dhe përcakton saktë shumën që subjekti i detyrohet këtij depozituesi, të cilën edhe e siguron pranë Agjencisë.".

Neni 3

Në nenin 32, "Depozitat e pasigurueshme", bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) depozitat e bankës, degës së bankës së huaj dhe shoqërisë së kursim-kreditit, në emër dhe për llogari të vet, si dhe çdo subjekt tjetër financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;".

2. Shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:

"ç) depozitat e drejtorit, administratorit në bankë dhe familjarëve të tyre, sipas certifikatës së gjendjes familjare;".

3. Shkronjat "e" dhe "ë" shfuqizohen.

4. Shkronja "i" ndryshohet si më poshtë:

"i) depozitat e njësive të pushtetit qendror ose vendor, si dhe çdo enti publik të Republikës së Shqipërisë ose të një vendi të huaj;".

5. Pas shkronjës "l" shtohet shkronja "ll" me këtë përmbajtje:

"ll) depozitat e personave juridikë, përveç atyre të përcaktuar në pikën 17, të nenit 3, të këtij ligji.".

Neni 4

Në nenin 39, "Procedura e kompensimit të depozitave", bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 6, shkronja "a", hiqen fjalët "që përcaktohet me mënyra të tjera pagese.".

2. Në pikën 7, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) përjashtimin nga listë-pagesa të depozitave të vendosura si kolateral, garanci ose në sekuestro.".

Neni 5

Në nenin 41, "Radha e pretendimeve të Agjencisë në rimarrje", pikat 2 dhe 6, hiqet fjala "e vegjël".

Neni 6

Në nenin 59, "Mjetet financiare", pikat 5 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

"5. Me synim sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga ky ligj, Agjencia, përveç veprimeve në tregjet financiare, mund t'i shesë Autoritetit Mbikëqyrës ose Ministrisë së Financave, me detyrim riblerjeje, titujt në të cilët janë investuar mjetet financiare të saj.

6. Agjencia hyn në marrëveshje me Autoritetin Mbikëqyrës dhe/ose Ministrinë e Financave për qëllimet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni.".

Neni 7

Në nenin 68, "Dispozita kalimtare", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. SHKK-të, që janë krijuar dhe kryejnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të plotësojnë të gjitha kushtet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet nënligjore të tij dhe brenda datës 31 maj 2016 të paraqesin në Agjenci kërkesën për anëtarësimin në skemë.".

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

"1/1. Unionet, që janë krijuar dhe kryejnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të plotësojnë të gjitha kushtet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet nënligjore të tij dhe brenda datës 31 maj 2016 të paraqesin në Agjenci kërkesën për përmbushjen e kushteve për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të shoqërive anëtare të kursim-kreditit dhe pranimin e tyre në skemë.

1/2. Agjencia vlerëson përmbushjen e kushteve dhe, brenda datës 30 nëntor 2016, lëshon vërtetimet për përmbushjen e kushteve, në përputhje me shkronjën "a", të nenit 19, të këtij ligji. Anëtarësimi në skemë i të gjitha SHKK-ve që kanë marrë vërtetimin për përmbushjen e kushteve kryhet në datën 1 janar 2017. SHKK-të, të cilat janë krijuar dhe kryejnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk u nënshtrohen përcaktimeve të pikës 13, të nenit 35, të këtij ligji.".

3. Në pikën 2, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Agjencia informon Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me SHKK-të dhe unionet që nuk plotësojnë kushtet dhe detyrimet e skemës së sigurimit të depozitave për zbatimin e kërkesave të pikës 2, të nenit 21, të këtij ligji.".

4. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Dispozitat e këtij ligji për sigurimin e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare në subjektet anëtare të skemës hyjnë në fuqi më 1 janar 2017.".

5. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Të gjitha aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, zbatohen për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me këtë ligj deri në zëvendësimin e tyre me akte të tjera nënligjore.".

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.4.2016

Shpallur me dekretin nr. 9550, datë 3.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 40/2016

PËR URDHRIN E PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të organizimit e të veprimtarisë së Urdhrit të Psikologut, si dhe të marrëdhënieve juridike e etiko-profesionale të psikologëve.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kritereve për ushtrimin e profesionit të psikologut, garantimi i standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të psikologut.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë psikologët që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin publik apo privat.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Psikolog" është një profesion i rregulluar, që ushtrohet në fushën e psikologjisë, bazuar në praktika, si: mbështetje psikologjike, diagnostikim, këshillim psikologjik, vlerësim, psikoterapi, ekspertizë, formim, këshillim karriere dhe punë në institucione dhe organizata.

2. "Praktikë profesionale" është ushtrimi i profesionit si psikolog nën mbikëqyrjen profesionale të psikologëve të kualifikuar si mbikëqyrës së praktikës profesionale.

Neni 5
Statusi

Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, në vijim Urdhri i Psikologut, është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtaritë e marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.

KREU II
MISIONI

Neni 6
Misioni

1. Misioni i Urdhrit të Psikologut është nxitja dhe ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e psikologjisë, si dhe mbrojtja e përfituesve të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit të psikologut.

2. Për realizimin e misionit të tij, Urdhri i Psikologut ushtron këto kompetenca:

a) jep dhe heq të drejtën për ushtrimin e profesionit të psikologut;

b) mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit të Psikologut dhe menaxhon sistemin e administrimit e të përditësimit të tij;

c) nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional e etik të anëtarëve të Urdhrit;

ç) vendos standarde etike e deontologjike, të detyrueshme për çdo psikolog dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;

d) mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre e të profesionit të psikologut;

dh) nxit dhe ndihmon marrjen e masave, me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar nga ushtruesit e profesionit dhe mbrojtjen e përfituesit të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit;

e) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, institucionet e tjera, shkencore dhe arsimore, për të siguruar standarde në edukimin e vazhdueshëm, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të Urdhrit;

ë) informon publikun, nëpërmjet faqes zyrtare të Urdhrit, për të gjitha aktet e miratuara nga organet e Urdhrit, të përcaktuara në këtë ligj.

KREU III
KRITERET E ANËTARËSISË

Neni 7
Kriteret e anëtarësisë

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e psikologut, në sistemin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga ky organizëm.

2. Anëtarët e Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë diplomën e studimeve të larta "Bachelor" dhe "Master shkencor" ose "Master profesional" në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;

ç) të mos jenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

Neni 8
Kriteret e anëtarësisë për shtetasit e huaj

1. Shtetasi i huaj, për ushtrimin e profesionit të psikologut në Republikën e Shqipërisë, duhet të anëtarësohet paraprakisht në Urdhrin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë. Çdo psikolog, shtetas i huaj, rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht, për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatën e mirësjelljes (*Good Standing Certificate*) nga urdhri/dhoma apo shoqata e psikologëve të vendit të vet, të njohur nga vendi ynë, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;

c) njohjen e diplomës e të certifikatave të specializimeve nga organi kompetent, të kryera prej tij/saj;

ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Psikologut;

d) dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, të vërtetuar nga një autoritet i licencuar nga shteti.

2. Për psikologun e huaj, i cili nuk njeh gjuhën shqipe, detyrimisht është kusht të punojë me përkthyes.

KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT TË URDHRIT

Neni 9
Të drejtat e anëtarit të Urdhrit të Psikologut

Anëtari i Urdhrit të Psikologut ka të drejtë:

a) të ushtrojë profesionin sipas titullit të përcaktuar në diplomën e "Masterit shkencor" dhe/ose "Masterit profesional";

b) të ankohet në organet e Urdhrit ndaj çdo subjekti që i shkel të drejtën dhe mundësinë për të ushtruar profesionin në mënyrë të lirë dhe të pavarur;

c) të marrë pjesë në shqyrtimin nga organet e Urdhrit për probleme që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit prej tij;

ç) të kërkojë krijimin e kushteve të favorshme për ushtrimin normal të profesionit, për edukimin e vazhdueshëm dhe për përparimin e karrierës;

d) të kërkojë mbrojtje të veçantë në rast rreziku gjatë ushtrimit të profesionit apo për rastet e rrezikut për jetën ndaj palëve të treta.

Neni 10
Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit

Anëtari i Urdhrit të Psikologut ka këto detyrime:

a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale, në përshtatje me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;

b) të punojë për rritjen e standardeve profesionale e të cilësisë së shërbimit në fushën e psikologjisë në institucionin ku punon dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit të vazhdueshëm;

c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, tarifën e dhënies të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbimeve të tjera administrative, të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.

KREU V
NDËRPRERJA E ANËTARËSISË

Neni 11
Ndërprerja e anëtarësimit

1. Anëtarit të Urdhrit të Psikologut i ndërpritet anëtarësisë kur:

a) vdes;

b) i hiqet licenca individuale e ushtrimit të profesionit, me vendim disiplinor të formës së prerë, nga organet e Urdhrit apo të gjykatës;

c) është duke vuajtur dënimin penal me heqje lirie;

ç) nuk shlyen kuotizacionet, në përputhje me afatet e vendosura nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit dhe nuk i respekton afatet e përcaktuara pa arsye të justifikueshme.

2. Vendimi për ndërprerje të anëtarësisë i komunikohet zyrtarisht, brenda 5 ditëve, personit dhe institucionit ku ka ushtruar profesionin si psikolog.

3. Procedura e anëtarësimit dhe ndërprerjes së anëtarësisë përcaktohet në statutin e Urdhrit të Psikologut, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar.

KREU VI
BASHKËPUNIMI

Neni 12
Bashkëpunimi

1. Urdhri i Psikologut, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministritë përgjegjëse për çështjet sociale, arsimin, shëndetësinë, drejtësinë, punët e brendshme, mbrojtjen dhe institucionet e tyre vartëse, institucionet e pavarura dhe organizma të tjerë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, publikë ose privatë.

2. Urdhri i Psikologut informon çdo 6 muaj ministritë e përmendura në pikën 1, të këtij neni, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, lidhur me anëtarësimet e psikologëve, gjykimet disiplinore dhe ecurinë e tyre në të gjitha shkallët e gjykimit profesional.

3. Inspektoratet në fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive të përmendura në pikën 1, të këtij neni, bashkëpunojnë me Urdhrin e Psikologut gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

4. Ministritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni bashkëpunojnë me Urdhrin për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumenteve të rëndësishme në fushën e shërbimeve psiko-sociale.

KREU VII
BUXHETI

Neni 13
Buxheti

1. Urdhri i Psikologut ka buxhetin e tij, të cilin e miraton dhe e administron Këshilli Kombëtar, në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga ky këshill.

2. Burimet financiare të Urdhrit të Psikologut janë:

a) kuotizacionet e anëtarëve, masa e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe që janë të detyrueshme për çdo anëtar;

b) tarifat e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri i Psikologut me vendim të Këshillit Kombëtar;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Urdhri i Psikologut i përdor të ardhurat e realizuara për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij, në përputhje me këtë ligj dhe statutin.

KREU VIII
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 14
Organet kryesore

Organet kryesore të Urdhrit janë:

a) Asambleja Kombëtare;

b) Këshilli Kombëtar;

c) Presidenti i Urdhrit;

ç) Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Neni 15
Asambleja Kombëtare

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues i Urdhrit dhe përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.

2. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga:

a) Presidenti i Urdhrit;

b) kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të asamblesë.

3. Asambleja Kombëtare ka këto funksione:

a) zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;

b) Miraton statutin e Urdhrit;

c) miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;

ç) miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;

d) miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe licencimin;

dh) miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;

e) shqyrton dhe miraton projektbuxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;

ë) analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;

f) shqyrton raportin e auditit të jashtëm, në intervale trevjeçare.

Neni 16
Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 17 anëtarë. Anëtarë të Këshillit Kombëtar janë:

a) Presidenti i Urdhrit;

b) nga një përfaqësues i ministrive përgjegjëse për arsimin, shëndetësinë, drejtësinë, mbrojtjen dhe çështjet sociale;

c) tre pedagogë të psikologjisë, me gradë shkencore Profesor, Prof. i Asociuar dhe Doktor Shkencash, që punojnë në institucione të arsimit të lartë, nga universitetet publike dhe private;

ç) shtatë psikologë që punojnë në shkolla, spitale, burgje, institucione komunitare, gjykatë, në zyra apo agjenci private, institucione rezidenciale, si dhe institucione varësie;

d) një anëtar nga Shoqatat e Psikologëve.

2. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

a) miraton strukturën e vet organizative;

b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;

c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;

ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;

d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim, Asamblesë Kombëtare;

dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;

e) ngre grupe pune a*d hoc* për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesionit të psikologut;

ë) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe financiar.

3. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 4 vjet.

Neni 17

Kriteret për anëtarësim në Këshillin Kombëtar

1. Anëtari i Këshillit Kombëtar duhet të plotësojë këto kritere:

a) të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Shqipëri;

b) të jetë anëtar i Urdhrit të Psikologut;

c) të këtë përvojë jo më pak se 5 vjet në ushtrimin e profesionit të psikologut;

ç) të mos ketë marrë masë disiplinore në 5 vitet e fundit dhe të mos ketë asnjë precedent penal.

2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar kanë të drejtën e vetëm një rizgjedhjeje.

Neni 18

Presidenti i Urdhrit

1. Presidenti i Urdhrit zgjidhet me votim të fshehtë nga Asambleja Kombëtare.

2. Mandati i presidentit është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Kandidaturat për president të Urdhrit të Psikologut duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;

b) të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë në profesion;

c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;

ç) të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore në 5 vitet e fundit;

d) të kenë prestigj dhe reputacion etiko-moral e profesional;

dh) të kenë kryer botime shkencore;

e) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

4. Funksioni i presidentit të Urdhrit të Psikologut është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.

5. Presidenti i Urdhrit e përfundon mandatin e tij përpara kohe kur:

a) merret vendim nga Asambleja Kombëtare, me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve;

b) jep dorëheqjen;

c) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) humbet zotësinë e plotë për të vepruar;

d) bëhet i paaftë, për arsye shëndetësore, për të kryer detyrat e tyre, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor.

6. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e presidentit të Urdhrit të Psikologut përcaktohen në statutin e Urdhrit.

Neni 19

Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionon Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional, si organizëm i gjykimit profesional. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.

2. Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë.

3. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit Etik të Gjykimit Disiplinor Profesional përcaktohet në statutin dhe në rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit.

Neni 20
Masat disiplinore

1. Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional heton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara dhe seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore.

Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione publike dhe private;

d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut deri në 3 vjet;

dh) përjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë deri në 3 vjet.

2. Masat disiplinore, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të shlyhen në qoftë se ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore:

a) brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij neni;

b) brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "d" e "dh", të pikës 1, të këtij neni.

3. Të ardhurat nga gjobat e mbledhura, në zbatim të shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni, kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

Neni 21
Ankimi

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i paraqiten Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

2. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës, e merr në shqyrtim ose ngre një komision *ad hoc* dhe jep vendimin për ankesën e paraqitur.

3. Vendimi i Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 22
Organizimi i zgjedhjeve të para

1. Ministri përgjegjës për çështjet sociale, me urdhër, ngre një komision të përkohshëm, i cili organizon zgjedhjet e para të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar, komisioni i përkohshëm shkrihet automatikisht.

Neni 23
Dispozita kalimtare

1. Personat, të cilët në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë përfunduar dy cikle studimi në psikologji, sipas shkronjës "b", të nenit 6, të këtij ligji ose ekuivalentë me të, regjistrohen në Urdhrin e Psikologut.

2. Personat, të cilët në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë profesionin e psikologut dhe kanë përfunduar dy cikle studimi në psikologji dhe që kanë përvojë 5-vjeçare, pa ndërprerje nga puna, në ushtrimin e profesionit të psikologut, regjistrohen në Urdhrin e Psikologut dhe duhet të kryejnë provimin e shtetit, brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.4.2016

Shpallur me dekretin nr. 9551, datë 3.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 41/2016

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN PËR NGRITJEN E QENDRËS SË EKSELENCËS NË FINANCË (CEF), BËRË NË BLED MË 3.9.2013

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrë-veshjen për ngritjen e Qendrës së Ekselencës në Financë (CEF), bërë në Bled më 3.9.2013.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.4.2016

Shpallur me dekretin nr. 9552, datë 3.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
PËR NGRITJEN E QENDRËS SË EKSELENCËS NË FINANCË (CEF)

Palët Kontraktuese të kësaj marrëveshjeje,

duke njohur rëndësinë jetike të nevojës për reforma financiare publike dhe të një sistemi bankingu qendror të qëndrueshëm në Evropën Juglindore dhe vendet e tjera;

duke qenë të vetëdijshme për nevojën e promovimit të standardeve ndërkombëtare në menaxhimin e financave publike, bankingut qendror dhe fusha të tjera të administratës publike;

duke ndarë nevojën për të zgjeruar më tej bashkëpunimin në menaxhimin e financave publike dhe sistemin e bankingut qendror;

me dëshirën për të zhvilluar shkëmbimin e njohurive, zhvillimin e kapaciteteve dhe asistencën teknike midis vendeve të Evropës Juglindore dhe vendeve të tjera, si edhe institucioneve dhe organizmave ndërkombëtarë;

duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë mbi bazën e parimeve të të drejtave të barabarta, sovranitetit shtetëror, integritetit territorial, mirëbesimit dhe marrëdhënieve të mira të fqinjësisë;

me dëshirën për të përmirësuar qëllimet e tyre të përbashkëta nëpërmjet themelimit të një organizate në bazë të një marrëveshjeje shumëpalëshe të hapur për vendet e Evropës Juglindore dhe vendet e tjera, si dhe për institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë;

duke iu përgjigjur ftesës së Republikës së Sllovenisë për të pritur një organizatë të tillë në Lubjanë, Sllloveni dhe duke rënë dakord për të zgjeruar privilegjet dhe imunitetet siç janë përcaktuar më poshtë, në territorin e të gjitha Palëve Kontraktuese,

kanë rënë dakord se CEF-i do të organizohet dhe do të veprojë në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e përdorur këtu do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

"CEF" nënkupton Qendrën e Ekselencës në Financë.

"Anëtarët e Bordit Drejtues" nënkupton ministrat e financave dhe guvernatorët e bankave qendrore apo drejtues të institucioneve të tjera përkatëse ose përfaqësuesit e tyre të emëruar.

"Veprimtari zyrtare" nënkupton ofrimin e trajnimit, asistencës teknike dhe profesionale dhe lehtësimin e rrjeteve, me qëllim zbatimin e reformave në menaxhimin e financave publike dhe sistemin qendror bankar.

"Drejtor" nënkupton drejtorin e CEF-it.

"Personel" nënkupton çdo punonjës të CEF-it.

"Ekspert" nënkupton çdo person të kontraktuar nga CEF-i për një periudhë afatshkurtër (deri në dymbëdhjetë muaj) për ofrimin e shërbimeve të kërkuara.

"Përfaqësues të anëtarëve të CEF-it" nënkupton anëtarët e delegacioneve të cilët marrin pjesë në mbledhjet e organizuara nga CEF-i;

"Mbledhje e organizuar nga CEF-i" nënkupton çdo mbledhje të çdo organi të CEF-it ose organi ndihmës apo ndonjë konferencë të zhvilluar nga CEF-i.

"Pronë" nënkupton të gjitha të ardhurat e CEF-it dhe të gjithë pasurinë, ku përfshihen fondet, sendet pasurore dhe pronat e tjera që i përkasin CEF-it, qoftë në pronësi apo të mbajtura/të administruara nga CEF-i, në pajtim me detyrat zyrtare të kryera nga CEF-i;

"Ambientet" nënkupton ndërtesat ose pjesë të ndërtesave, duke përfshirë ato ndihmëse, të përdorura vetëm për qëllime të CEF-it, pavarësisht nga pronësia;

"Arkiva" nënkupton të gjithë regjistrat, korrespondencën, dokumentet, doreshkrimet, të dhënat kompjuterike dhe ato mediatike, fotografitë, filmat, videot, regjistrimet zanore dhe çdo të dhënë tjetër që i përket ose mbahet nga CEF-i.

"Anëtarë të familjes" nënkupton bashkëshortët dhe partnerët sipas së drejtës zakonore të Personelit, fëmijët e pamartuar në varësi të Personelit deri në 18 vjeç ose 26 vjeç, nëse janë të regjistruar si studentë me kohë të plotë në institucionet arsimore postsekondare dhe fëmijët e pamartuar të personelit, të cilët janë të paaftë fizikisht ose mendërisht.

"Vendi pritës" nënkupton vendin ku është vendosur selia e CEF-it.

Çdo referencë ndaj një personi të gjinisë mashkullore do të konsiderohet, gjithashtu, se përbën një referencë ndaj një personi të seksit femër dhe anasjelltas.

Neni 2
Themelimi dhe statusi

CEF-i ka personalitet juridik ndërkombëtar.

Neni 3
Qëllimi dhe veprimtaritë

1. Qëllimi i CEF-it është nxitja e shkëmbimit të njohurive, ofrimi i trajnimeve dhe lehtësimi i asistencës teknike në menaxhimin e financave publike, sistemin e bankingut qendror dhe fusha të tjera të administratës publike.

2. CEF-i kryen veprimtaritë e tij nëpërmjet trajnimit të fokusuar dhe të përshtatur të orientuar ndaj kërkesës dhe në planin praktik, si dhe asistencës teknike, nxitjes dhe mbështetjes së bashkëpunimit në rajon, përfshirë mbajtjen e plat-formave për mësimin në grup dhe mbështetjen e komuniteteve të praktikës, krijimin e partneriteteve të reja, shkëmbimit të përvojës dhe elementeve të tjera të ngjashme, në mënyrë që të trajtohen sfidat me të cilat përballen shtetet e tij anëtare.

3. CEF-i, duke vepruar si lehtësues dhe katalizator, duke siguruar përvojë për aplikimet dhe politikat praktike, duke ofruar mbështetje për të gjitha çështjet që lidhen me menaxhimin financiar publik dhe veprimtarinë e bankingut qendror, duke ndihmuar vendet për të përfituar nga zhvillimi efikas dhe transferimi i njohurive dhe praktikave më të mira, kryen veprimtaritë e mëposhtme, veçanërisht në favor të anëtarëve të CEF-it:

a) Asistimin në zbatimin e reformave për menaxhimin financiar publik dhe forcimin e sistemit të bankingut qendror përmes veprimtarive të projektuara sipas vendeve;

b) Nisjen e diskutimit dhe sigurimin e ndërveprimit me organizmat e tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë, në mbështetje të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm, i cili bën të mundur menaxhimin me efikasitet të financave publike dhe sistemit të bankingut qendror;

c) Sigurimin e qasjeve në njohuritë më të fundit dhe përvojën praktike në menaxhimin e financave publike dhe sistemin e bankingut qendror, duke ofruar mbështetje për anëtarët e tyre në zhvillimin e zgjidhjeve individuale;

d) Përmirësimin e transferimit të njohurive dhe të teknologjisë, si dhe promovimin e zhvillimit të kapaciteteve lokale dhe kompetencës tek anëtarët e CEF-it, duke përfshirë ndërlidhjet e nevojshme;

e) Ofrimin e ndërtimit të kapaciteteve nëpërmjet programeve të certifikuara të trajnimit dhe edukimit;

f) Shërben si pikë takimi për shkëmbimin e ekspertizës dhe përvojës së fituar në procesin e reformave;

g) Kryerjen dhe inkurajimin e kryerjes së kërkimeve për t'iu përgjigjur nevojave të zhvillimit të kapacitetit rajonal;

h) Ofrimin e mundësive për zyrtarët e rajonit të anëtarëve të CEF-it për të studiuar zbatimin e standardeve ndërkombëtare, praktikat dhe tendencat më të mira, të gjitha nën drejtimin e ekspertëve të kualifikuar ndërkombëtarë të nivelit të lartë;

i) Veprimtari të tjera të përcaktuara nga Bordi Drejtues.

Neni 4
Zotësia juridike

CEF-i do të ketë zotësinë e nevojshme juridike për ushtrimin e funksioneve të saj, duke përfshirë kapacitetin për të kontraktuar, marrë dhe disponuar pronat e luajtshme dhe të paluajtshme, për t'u përfshirë dhe për t'u përgjigjur në procedurat ligjore dhe për të ndërmarrë veprime të tjera që mund të jenë të nevojshme ose të dobishme për qëllimet dhe veprimtaritë e saj.

Neni 5
Marrëdhënia bashkëpunuese

CEF-i do të përpiqet të krijojë marrëdhënie me përfitim të ndërsjellë me institucionet ekzistuese dhe organizatat për të shmangur dyfishimin e panevojshëm të punës.

ANËTARËT

Neni 6
Anëtarësimi

1. Anëtarësimi është i hapur ndaj çdo organizate shtetërore dhe ndërkombëtare të gatshme dhe të aftë për të vepruar në përputhje me qëllimet dhe veprimtaritë e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2. Një shtet i tillë dhe organizatë ndërkombëtare bëhet:

a) anëtar themelues i CEF-it, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe pas depozitimit të një instrumenti ratifikimi.

b) anëtarë të tjerë të CEF-it nëpërmjet depozitimit të një instrumenti aderimi, pas miratimit të aplikimit të tyre për anëtarësim.

Neni 7
Pranimi

1. CEF-i është e hapur për pranim ndaj çdo organizate shtetërore dhe ndërkombëtare me interes të veçantë në nxitjen e shkëmbimit të njohurive, ofrimit të trajnimeve dhe lehtësimin e asistencës teknike në menaxhimin financiar publik, sistemin e bankingut qendror dhe fushat e tjera të administratës publike tek anëtarët e CEF-it dhe që aplikon për anëtarësim, pajtohet me qëllimet dhe veprimtaritë e CEF-it siç janë përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe plotëson kriteret e vendosura nga Bordi Drejtues.

2. Aplikimet për anëtarësim i paraqiten Bordit Drejtues për shqyrtim dhe miratim. Pas miratimit, shteti kërkues ose organizata ndërkombëtare do të ftohen nga Bordi Drejtues për të aderuar në këtë Marrëveshje në pajtim me paragrafin 3 të nenit 27.

ORGANIZIMI

Neni 8
Struktura organizative

1. CEF-i vepron në mënyrë fleksibël. Ai ka organet kryesore të mëposhtme:

a) Bordi Drejtues;

b) Bordi Këshillimor;

c) Sekretariati.

2. Bordi Drejtues mund të krijojë organe ndihmëse, sipas nevojës, për ushtrimin e funksioneve të tij në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 9
Bordi Drejtues

1. Çdo anëtar i CEF-it, i cili është një shtet, do të ketë deri dy anëtarë të Bordit Drejtues dhe secili një zëvendës për të vepruar në emër të tyre, kur ata nuk janë në gjendje të shërbejnë. Anëtarët e Bordit Drejtues janë ministra të financave dhe/ose guvernatorë të bankave qendrore apo drejtues të institucioneve të tjera përkatëse.

2. Çdo anëtar i CEF-it që është një organizatë ndërkombëtare, do të ketë një anëtar në Bordin Drejtues dhe një zëvendës për të vepruar në emër të tij, kur ai nuk është në gjendje të shërbejë. Anëtari i Bordit Drejtues është kreu i organizatës ndërkombëtare ose përfaqësuesi i tij i emëruar.

3. Anëtarët e Bordit Drejtues janë, gjithashtu, deri në tre përfaqësues të Bordit Këshillimor, që shërbejnë si anëtarë të Bordit Drejtues për një periudhë prej tre vjetësh.

4. Drejtori do të jetë një anëtar i Bordit Drejtues (si anëtar i caktuar kryesisht) pa të drejtë votimi.

5. Bordi Drejtues:

a) mbikëqyr veprimtaritë e CEF-it;

b) miraton programin vjetor të punës dhe buxhetin vjetor;

c) kryen raportin e biznesit dhe pasqyrat financiare;

d) emëron një drejtor dhe një auditues të jashtëm të CEF-it;

e) miraton amendamentet e kësaj Marrëveshjeje;

f) autorizon drejtorin për të negociuar marrëveshjet dhe kontratat ndërkombëtare;

g) miraton lidhjen e marrëveshjeve dhe kontratave ndërkombëtare;

h) vendos kriteret për pranimin e shteteve dhe organizmave ndërkombëtarë në CEF;

i) shqyrton dhe miraton kërkesën për anëtarësim;

j) miraton rregullat financiare dhe rregulloret, si dhe rregulloren e punës dhe rregulloren e punësimit, me qëllim specifikimin e performancës të të gjitha organeve të saj dhe rregullave të tjera të brendshme.

6. Çdo anëtar i Bordit Drejtues ka një votë. Rregullat e votimit përcaktohen në rregullat e procedurës që do të miratohen unanimisht nga Bordi Drejtues.

7. Mbledhjet e Bordit Drejtues do të thirren të paktën një herë në çdo vit kalendarik. Përveç kësaj, një mbledhje mund të kërkohet, gjithashtu, nga çdo anëtar i CEF-it, në pajtim me rregullat e procedurës.

Neni 10
Bordi Këshillimor

1. Bordi Këshillimor do të ndihmojë për hartimin dhe koordinimin e kryerjes së veprimtarive të CEF-it.

2. Anëtarët e Bordit Këshillimor, me kërkesën e tyre ose me ftesë të CEF-it, mirëpresin donatorët aktivë në rajon dhe institucionet e tjera bashkëpunuese me CEF-in.

3. Bordi Këshillimor mblidhet të paktën një herë në çdo vit kalendarik. Përveç kësaj, mund të kërkohet një mbledhje edhe nga secili prej anëtarëve.

4. Çdo tre vjet anëtarët e Bordit Këshillimor duhet të zgjedhin midis tyre deri në tre përfaqësues për të përfaqësuar Bordin Këshillimor në Bordin Drejtues.

5. Çdo vit, përfaqësues të Bordit Këshillimor në Bordin Drejtues, zgjedhin midis tyre një kryetar.

Neni 11
Sekretariati

1. Sekretariati përbëhet nga drejtori, personeli dhe ekspertët.

2. Bordi Drejtues emëron drejtorin për një mandat prej pesë vitesh. Procesi i përzgjedhjes përcaktohet në rregullat e procedurës.

3. Drejtori është përgjegjës ndaj Bordit Drejtues në lidhje me kryerjen e detyrave të tij/saj. Drejtori merr udhëzime vetëm nga Bordi Drejtues.

4. Drejtori:

a) garanton funksionimin e duhur, të rregullt dhe efikas të CEF-it;

b) vepron në emër të CEF-it, duke përfshirë nënshkrimin e Marrëveshjes së selisë qendrore, marrëveshjeve dhe kontratave të tjera të nevojshme ndërkombëtare për funksionimin e CEF-it;

c) raporton në Bordin Drejtues;

d) i paraqet Bordit Drejtues një draftprogram vjetor të punës, propozimin e buxhetit dhe raporton mbi zbatimin e tyre;

e) i raporton Bordit Drejtues mbi çdo çështje tjetër për funksionimin e CEF-it, siç mund të kërkohet nga Bordi Drejtues.

5. Rregullorja e punësimit përmban parimet dhe procedurat që rregullojnë përzgjedhjen e personelit, punësimin dhe përshkrimin e vendeve të tyre të punës, për të arritur funksionimin efektiv të sekretariatit për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

PRIVILEGJET DHE IMUNITETET

Neni 12
Imuniteti nga procesi ligjor

1. CEF-i dhe prona e tij, pavarësisht ku ndodhen dhe nga kush zotërohen, gëzojnë imunitet nga çdo formë e procesit juridik, duke përjashtuar nevojën që në një rast të veçantë, Këshilli Drejtues, me vendim të tij, autorizon heqjen e këtij imuniteti.

2. Pa cenuar paragrafin e mësipërm, CEF nuk gëzon imunitet në lidhje me:

a) një padi civile në bazë të një detyrimi kontraktual të CEF-it;

b) një kundërpadi e lidhur drejtpërdrejt me procedimet e filluara nga CEF-i;

c) një padi civile që lidhet me kompensimin monetar për vdekje apo dëmtim të personit ose dëmtimit ose humbjes së pronës materiale, të shkaktuar nga një veprim ose mosveprim, i cili supozohet t'i atribuohet CEF-it.

3. Asnjë heqje e tillë e imunitetit nuk shtrihet te ndonjë masë ekzekutimi për të cilën do të kërkohet një dokument i veçantë pezullimi.

Neni 13
Pacenueshmëria

1. Ambientet e CEF-it janë të pacenueshme.

2. Prona e CEF-it, pavarësisht ku ndodhet dhe nga kush zotërohet, gëzon imunitet nga kërkimi, rekuizimi, konfiskimi, shpronësimi apo ndonjë formë tjetër e ndërhyrjes, qoftë nga veprimi ekzekutiv, administrativ, gjyqësor apo legjislativ.

3. Arkivat e CEF-it dhe më përgjithësisht të gjitha dokumentet që i përkasin atij apo që mbahen prej tij, janë të pacenueshme, pavarësisht ku ndodhen dhe nga kush zotërohen.

Neni 14
Lehtësitë dhe imunitetet në lidhje me komunikimet dhe publikimet

1. CEF-i do të komunikojë lirisht dhe pa nevojën për leje të veçantë, për të gjitha qëllimet zyrtare dhe anëtarët e CEF-it duhet të mbrojnë të drejtën e CEF-it për ta bërë këtë.

2. CEF-i gëzon, për komunikimet e tij zyrtare, trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që u është siguruar anëtarëve të CEF-it për misionet diplomatike të të gjitha shteteve.

3. Të gjitha komunikimet drejtuar CEF-it dhe të gjitha komunikimet zyrtare nga CEF-i, të transmetuara me çfarëdo mjeti apo në çfarëdo forme, janë të pacenueshme.

Neni 15
Përjashtimet

1. Brenda objektit të veprimtarive të tij zyrtare, CEF-i dhe prona e tij përjashtohen nga:

a) taksat doganore mbi importin apo eksportin e mallrave për përdorim zyrtar, me kusht që mallrat e importuara të mos shiten ose ndryshe të mos vihen në dispozicion në territorin e anëtarit të CEF-it në fjalë, përveçse sipas kushteve të miratuara nga ai anëtar i CEF-it;

b) taksat doganore mbi importin apo eksportin e publikimeve për qëllime zyrtare;

c) tatimi indirekt për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, i ofruar për përdorim zyrtar, në të njëjtat kushte që zbatohen për misionet diplomatike në territorin e anëtarit të CEF-it në fjalë.

2. Përjashtimet e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni mund të jepen me anë të përjashtimit të drejtpërdrejtë ose një rimbursimi të tatimit të paguar sipas të njëjtave procedura që zbatohen për misionet diplomatike në territorin e anëtarit të CEF-it në fjalë.

Neni 16
Liria e aktivëve financiarë nga kufizimet

Pa iu nënshtruar kontrolleve financiare ose moratoriumeve të ndonjë lloji, CEF-i mundet që brenda territorit të anëtarëve të CEF-it, lirisht

a) të blejë ndonjë valutë nëpërmjet kanaleve të autorizuara dhe t'i mbajë ose disponojë ato; dhe

b) të kryejë veprime në llogari në çdo valutë.

Neni 17
Flamuri, emblema dhe etiketat

CEF-i ka të drejtë të vendosë flamurin, logon e tij dhe etiketat e tjera të miratuara nga Këshilli Drejtues i CEF-it, në ambientet e tij dhe në mjetet motorike të përdorura për qëllime zyrtare.

Neni 18
Privilegjet dhe imunitetet e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe përfaqësuesve të anëtarëve të CEF-it

Anëtarët e Bordit Drejtues dhe përfaqësuesit e anëtarëve të CEF-it, gjatë ushtrimit të misionit të tyre në CEF dhe udhëtimit të tyre për në dhe nga vendi i takimeve të organizuara nga CEF-i, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) kanë imunitet nga procesi ligjor edhe pas përfundimit të detyrave të tyre në CEF, në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare dhe brenda kufijve të autoritetit të tyre;

b) pacenueshmëri të dokumenteve zyrtare, të dhënave dhe materialeve të tjera zyrtare në zotërim të tyre.

Neni 19
Privilegjet dhe imunitetet e drejtorit

1. Drejtori:

a) ka imunitet ndaj arrestimit personal dhe ndalimit për veprimet e kryera në cilësinë e tij zyrtare;

b) ka imunitet ndaj sekuestrimit të bagazheve të tij personale;

c) ka imunitet nga procesi ligjor edhe pas përfundimit të detyrave të tij në CEF, në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara dhe për të gjitha veprimet e kryera prej tij në cilësinë e tij zyrtare dhe brenda kufijve të kompetencave të tij;

d) përjashtohet nga tatimi i mbajtur në rroga të paguara atij nga CEF-i;

e) përfiton, së bashku me anëtarët e familjes së tij, të njëjtat lehtësira riatdhesimi në kohë krize ndërkombëtare siç iu akordohet shefave të misioneve diplomatike;

f) nuk është i detyruar të japë dëshmi si dëshmitar në lidhje me detyrat e tij zyrtare;

g) gëzon pacenueshmërinë e të gjitha letrave, dokumenteve dhe materialeve të tjera zyrtare të lidhura me CEF-in.

Privilegjet dhe imunitetet e drejtorit, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, pikat "d" dhe "e", nuk zbatohen ndaj anëtarit të CEF-it në të cilin individi është rezident ose shtetas i përhershëm.

Neni 20
Privilegjet dhe imunitetet e personelit

1. Personeli:

a) ka imunitet nga procesi ligjor edhe pas përfundimit të detyrave të tij në CEF, në lidhje me fjalët e thëna apo të shkruara dhe për të gjitha veprimet e kryera prej tij në cilësinë e tij zyrtare dhe brenda kufijve të kompetencave të tij;

b) përjashtohet nga tatimi i mbajtur në rroga të paguara atij nga CEF-i;

c) përfiton, së bashku me anëtarët e familjes së tij, të njëjtat lehtësira riatdhesimi në kohë krize ndërkombëtare që i jepen stafit teknik-administrativ të misioneve diplomatike.

d) gëzon paprekshmërinë e të gjitha letrave, dokumenteve dhe materialeve të tjera zyrtare të lidhura me CEF-in.

2. Privilegjet dhe imunitetet e personelit, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, pikat "b" dhe "c", nuk zbatohen ndaj anëtarit të CEF-it në të cilin individi është rezident ose shtetas i përhershëm.

Neni 21
Kohëzgjatja e privilegjeve dhe imuniteteve

1. Në territorin e Palëve Kontraktuese, çdokush që gëzon të drejtën e privilegjeve dhe imuniteteve në përputhje me nenet 18, 19, 20 dhe 22, gëzon privilegje dhe imunitete nga momenti kur ai merr pozicionin e tij në CEF ose nëse kjo nuk është kryer paraprakisht që nga momenti kur marrja e postit prej tij u njoftohet autoriteteve kompetente të vendit pritës.

2. Kur funksionet e këtyre personave përfundojnë, privilegjet dhe imunitetet që gëzojnë në territorin e Palëve Kontraktuese normalisht ndërpriten në momentin kur largohen nga anëtari i CEF-it ose me përfundimin e një periudhe të arsyeshme për të kryer një gjë të tillë. Megjithatë, në respektim të veprimeve të kryera nga këta persona gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, imuniteti do të vijojë.

3. Drejtori, personeli dhe anëtarët e familjeve të tyre gëzojnë të drejtën e nxjerrjes së kartave të duhura të identitetit, të lëshuara nga autoriteti kompetent i vendit pritës, të cilat, së bashku me dokumentet e tyre personale kombëtare ose të udhëtimit, provojnë identitetin dhe statusin e tyre të veçantë.

Neni 22
Heqja e imuniteteve

1. Privilegjet dhe imunitetet në këtë Marrëveshje nuk jepen për përfitime personale të vetë individëve por me qëllim mbrojtjen e ushtrimit të pavarur të funksioneve të tyre në lidhje me CEF-in, për periudhën e cilësisë së tyre zyrtare.

2. Është detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegje dhe imunitete të tilla në përputhje me këtë Marrëveshje, të respektojnë ligjet dhe rregulloret e vendit pritës dhe Palëve të tjera Kontraktuese.

3. Kompetenca e heqjes së imunitetit do të jetë si më poshtë:

a) në lidhje me anëtarët e Bordit Drejtues dhe përfaqësuesve të shteteve anëtare, heqja e imunitetit do të jetë në kompetencën e anëtarit të CEF-it që i emëron ata. Anëtari i tillë i CEF do të ketë të drejtën dhe detyrën të heqë imunitetin në rastet kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të

pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe nuk do të ndikojë te qëllimet për të cilat është dhënë imuniteti;

b) në lidhje me drejtorin, Bordi Drejtues ka të drejtën dhe detyrën për heqjen e imunitetit ku imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe ku ai mund të hiqet pa cenuar interesat e CEF-it;

c) në lidhje me një anëtar të personelit, drejtori do të ketë të drejtën dhe detyrën për heqjen e imunitetit ku imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e CEF-it.

4. Asnjë heqje e tillë e imunitetit nuk do të çojë në ndonjë masë ekzekutimi për të cilën do të kërkohej një dokument i veçantë i heqjes dorë.

5. CEF-i do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet kompetente të anëtarëve të CEF-it për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë dhe do të parandalojë çdo abuzim me privilegjet dhe imunitetet e dhëna sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 23

Burimet financiare

1. Burimet financiare të CEF-it do të përfshijnë sa më poshtë:

a) kontributin në natyrë, në formën e hapësirës për zyrë që do të përdoret nga CEF-i për kryerjen e veprimtarive të tij, vënë në dispozicion nga vendi pritës në përputhje me Marrëveshjen e selisë qendrore;

b) Një kontribut financiar nga vendi pritës për të financuar operacionet e CEF-it në një sasi të arsyeshme;

c) Kontribute vullnetare nga donatorët;

d) Të ardhurat nga kontributet e tilla;

e) Të ardhurat nga operacionet;

f) Burimet e tjera të të ardhurave.

2. Viti fiskal i CEF-it do të jetë viti kalendarik.

3. Çdo vit, drejtori do të përgatitë dhe dorëzojë Bordit Drejtues, një raport biznesi që përmban deklaratën e audituar të llogarive të CEF-it dhe një përmbledhje të veprimtarive të CEF-it. Auditimi vjetor do të kryhet nga një auditues i jashtëm i pavarur i CEF-it i emëruar nga Bordi Drejtues.

4. Rregullat dhe rregulloret financiare miratohen nga Bordi Drejtues.

Neni 24

Dispozitat e përkohshme

Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe pronat që i përkasin *Regionalna ustanova - Center za razvoj financ* do të transferohen te CEF-i në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 25

Rezervat

Kësaj Marrëveshje nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Neni 26

Selia qendrore dhe gjuha zyrtare

1. Selia qendrore e CEF-it do të vendoset në Lubjanë, Slloveni, sipas termave dhe kushteve të rëna dakord ndërmjet CEF-it dhe Republikës së Sllovenisë.

2. CEF-i mund të krijojë lehtësira në vende të tjera, siç kërkohet për të mbështetur veprimtaritë e saj, për të maksimizuar rezultatet dhe për të rritur efikasitetin e saj. Termat dhe kushtet e krijimit të objekteve të tilla do të bihen dakord ndërmjet CEF-it dhe vendit përkatës pritës para vendosjes së tyre.

3. Gjuha zyrtare e CEF-it do të jetë gjuha angleze.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim për çdo shtet dhe organizatë ndërkombëtare deri në datën e hyrjes së saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese dhe organizatat ndërkombëtare, në përputhje me kërkesat e tyre përkatëse ligjore.

3. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim për shtetet dhe organizmat ndërkombëtarë të cilët nuk e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje, pasi aplikimi i tyre për anëtarësim të jetë miratuar.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen te Depozitari.

Neni 28
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit te Depozitari.

2. Për çdo shtet ose organizatë ndërkombëtare, e cila ratifikon ose aderon në këtë Marrëveshje pas datës së hyrjes së saj në fuqi, siç parashikohet në paragrafin 1, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të instrumenteve përkatëse.

Neni 29
Amendamentet

1. Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje mund të propozohen nga çdo anëtar i CEF-it. Kopje të vërtetuara të tekstit të çdo amendamenti të propozuar do të përgatiten nga drejtori dhe do të komunikohen te të gjithë anëtarët, të paktën nëntëdhjetë ditë para shqyrtimit të tij nga Bordi Drejtues.

2. Amendamentet hyjnë në fuqi për të gjithë anëtarët e CEF-it:

a) kur miratohen nga Bordi Drejtues, pas shqyrtimit të vërejtjeve të paraqitura nga drejtori për çdo amendament të propozuar; dhe

b) pasi të gjithë anëtarët e CEF-it kanë dhënë pëlqimin për të respektuar amendamentin në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese. Anëtarët e CEF-it duhet të shprehin pëlqimin e tyre, duke depozituar një instrument përkatës te depozitari.

Neni 30
Tërheqja dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje mund të përfundojë me marrëveshje të përbashkët të anëtarëve të CEF-it.

2. Çdo anëtar i CEF-it mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, duke i dhënë një njoftim me shkrim depozitarit të kësaj Marrëveshjeje, i cili menjëherë do t'ua komunikojë anëtarëve të tjerë të CEF-it.

3. Njoftimi i tillë i tërheqjes do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari, përveç kur ky njoftim tërhiqet paraprakisht ose anëtarët e CEF-it bien dakord reciprokisht ndryshe.

4. Nëse të gjithë anëtarët e tjerë të CEF-it bien dakord ndryshe, tërheqja, siç referohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk e liron anëtarin njoftues të CEF-it nga ndonjë prej angazhimeve të tij në lidhje me programet, projektet dhe studimet e filluara sipas kësaj Marrëveshjeje.

5. Në rast të përfundimit të kësaj marrëveshjeje, CEF-i do të përpiqet, në masën e mundshme, të përfundojë projektet në vazhdim. Pas përfundimit të veprimtarive të tilla, prona neto e CEF-it do të transferohet në qeverinë e Sllovenisë.

Neni 31
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet CEF-it dhe çdo anëtari të CEF-it ose ndërmjet anëtarëve të CEF-it, do të zgjidhet me anë të bisedimeve ose mjeteve të tjera të miratuara të zgjidhjes paqësore.

Neni 32
Depozitari

1. Qeveria e Republikës së Sllovenisë do të veprojë si depozitari.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, depozitari duhet të sigurojë regjistrimin e tij në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

3. Origjinali i kësaj Marrëveshjeje, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, do të depozitohet te depozitari, i cili do të transmetojë një kopje të vërtetuar për çdo anëtar të CEF-it.

Në dëshmi sa më sipër, të poshtënënshkruarit, të autorizuar në mënyrë të rregullt, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Bled, më …… 2013.

Për Republikën e Bullgarisë

_____

Për Republikën e Kroacisë

_____

Për Republikën e Maqedonisë

_____

Për Malin e Zi

_____

Për Republikën e Sllovenisë

_____

LIGJ
Nr. 42/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE RUMANISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për mbrojtjen shoqërore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.4.2016

Shpallur me dekretin nr. 9553, datë 3.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE RUMANISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë dhe Rumania, më poshtë të quajtura "Palë Kontraktuese",

të nxitura nga dëshira për të rregulluar dhe zhvilluar marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve në fushën e mbrojtjes shoqërore,

kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat dhe shprehjet e mëposhtme nënkuptojnë:

a) "Territor"

- Për Republikën e Shqipërisë, i gjithë territori shtetëror i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi të, ku Republika e Shqipërisë ushtron sovranitetin e vet, si dhe zonën kufitare, ndarjen tokësore dhe zonën e përcaktuar ekonomike, ku Republika e Shqipërisë ushtron të drejtat sovrane dhe juridiksionin e vet, në përputhje me ligjet e saj dhe me rregullat e parimet e së drejtës ndërkombëtare.

- Për Rumaninë, i gjithë territori shtetëror i Rumanisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi të, ku Rumania ushtron sovranitetin e vet, si dhe zonën kufitare, ndarjen tokësore dhe zonën e përcaktuar ekonomike, ku Rumania ushtron të drejtat sovrane dhe juridiksionin e vet, në përputhje me ligjet e saj dhe me rregullat e parimet e së drejtës ndërkombëtare.

b) "Legjislacion", ligjet dhe rregullat në lidhje me mbrojtjen shoqërore, të përcaktuara në nenin 2;

c) "Autoritet kompetent", ministritë përgjegjëse për fushat e parashikuar në nenin 2;

d) "Institucion", organi apo autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes shoqërore, të parashikuar në nenin 2;

e) "Institucion kompetent", institucioni në të cilin personi është i siguruar në kohën e paraqitjes së kërkesës për përfitime apo institucioni që i ka njohur personit të drejtën për përfitime apo do t'i njihte të drejtën për përfitime apo institucioni i caktuar nga autoriteti kompetent;

f) "Organ ndërlidhës", institucionet e caktuara nga autoritetet kompetente për të siguruar lidhje të drejtpërdrejta për qëllim të kësaj Marrëveshjeje;

g) "Përfitim në natyrë", kujdesi shëndetësor, medikamentet dhe pajisjet mjekësore, sipas legjislacionit të përmendur në nenin 2;

h) "Përfitim në para", pensionet, pagesat, dëmshpërblimet dhe përfitimet e tjera në para, si dhe të gjitha kompensimet e tyre, shtesat, rritjet dhe ndryshimet në përputhje me legjislacionin e përcaktuar në nenin 2;

i) "Vendbanim", vendbanimi i zakonshëm;

j) "Qëndrim", vendbanimi i përkohshëm;

k) "Periudhë sigurimi", periudhat e kontributit dhe periudhat e barasvlershme të plotësuara sipas legjislacionit të secilës Palë Kontraktuese;

l) "Person i siguruar", personi që është apo ka qenë subjekt i legjislacionit të përmendur në nenin 2.

2. Termat dhe shprehjet e tjera që janë përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet e përcaktuara për to në legjislacionin e zbatuar prej secilës Palë Kontraktuese.

Neni 2
Hapësira materiale

1. Kjo Marrëveshje zbatohet:

a) për Rumaninë, për legjislacionin që rregullon:

1) dëmshpërblimin për paaftësi të përkohshme në punë si pasojë e sëmundjeve të përgjithshme apo dëmtimeve të shkaktuara jashtë vendit të punës;

2) trajtimin për barrëlindje;

3) pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

4) pagesat për vdekje.

5) përfitimet në natyrë dhe në para në rast sëmundjeje dhe barrëlindjeje;

6) përfitimet në natyrë dhe në para në rast aksidentesh në punë dhe sëmundjesh profesionale.

b) për Republikën e Shqipërisë, për legjislacionin që rregullon:

Skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore,

i) përfitimet për sëmundje në para për personat e punësuar;

ii) përfitimet për barrëlindje në para për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

iii) përfitimet për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale për personat e punësuar;

iv) pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet familjare për personat e punësuar, të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit.

Në lidhje me skemën e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore:

i) përfitimet në natyrë të skemës së detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.

2. Kjo Marrëveshje zbatohet, gjithashtu, për të gjitha dispozitat ligjore që kodifikojnë, zëvendësojnë, amendojnë apo plotësojnë legjislacionin e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Nëse autoritetet kompetente nuk bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje nuk zbatohet për legjislacionin që parashikon një skemë të re të mbrojtjes shoqërore.

Neni 3
Hapësira personale

Kjo Marrëveshje zbatohet për të gjithë personat që janë apo kanë qenë subjekt i legjislacionit të njërës apo të të dyja Palëve Kontraktuese, si dhe për personat e tjerë në masën që të drejtat e tyre rrjedhin nga këta persona.

Neni 4
Trajtimi i barabartë

Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat që janë apo kanë qenë subjekt i legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese, kur janë rezidentë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime në bazë të legjislacionit të kësaj Pale Kontraktuese si të jenë shtetas të saj.

Neni 5
Transferimi i përfitimeve

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, ndonjë dispozitë e legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese, e cila njeh të drejtat dhe kryen pagesën e përfitimeve me kusht rezidencën në territorin e saj, nuk zbatohet nëse personi është rezident në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për përfitimet në para për paaftësi të përkohshme në punë dhe për përfitime të veçanta jokontributive në para.

Neni 6
Shmangia e mbivendosjes së përfitimeve

1. Kjo Marrëveshje nuk mund të parashikojë apo të ruajë të drejtën për dy apo më shumë përfitime që mbulojnë të njëjtin risk të dhënë për të njëjtën periudhë sigurimi.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen për përfitimet që lidhen me invaliditetin, pleqërinë, humbjen e mbajtësit të familjes apo me sëmundjet profesionale, të cilat paguhen nga institucionet kompetente të të dyja

Palëve Kontraktuese, në përputhje me dispozitat e nenit 19 dhe nenit 24/b.

PJESA II
LEGJISLACIONI NË FUQI

Neni 7
Rregulla të përgjithshme

Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje:

1. Personat që janë të punësuar në territorin e njërës Palë Kontraktuese janë subjekt vetëm i legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese, edhe nëse ata kanë rezidencën në territorin e Palës tjetër Kontraktuese apo nëse punëdhënësi ka rezidencën e vet apo zyrat qendrore në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Të vetëpunësuarit që kryejnë aktivitete në territorin e një Pale Kontraktuese janë subjekt i legjislacionit të kësaj Pale Kontraktuese, edhe nëse ata kanë rezidencën në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Punonjësit e shërbimit civil dhe personeli ekuivalent janë subjekt i legjislacionit të Palës Kontraktuese në administratën e së cilës janë punësuar.

Neni 8
Kryerja e aktiviteteve nga personat e punësuar dhe/ose të vetëpunësuar në territorin e të dyja Palëve Kontraktuese

1. Një person që kryen aktivitete të njëkohshme si person i punësuar në territorin e të dyja Palëve Kontraktuese është subjekt vetëm i legjislacionit të Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës ai/ajo ka vendin e tij/saj të banimit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 9.

2. Një person që kryen një aktivitet si person i punësuar në territorin e një Pale Kontraktuese, si dhe një aktivitet si person i vetëpunësuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese është subjekt i legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ai/ajo kryen aktivitetin e tij/saj si person i punësuar.

3. Një person që kryen aktivitete vetëpunësimi të njëkohshme në territorin e të dyja Palëve Kontraktuese është subjekt vetëm i legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ai/ajo ka vendbanimin e tij/saj.

Neni 9
Punonjësit e dërguar me punë

1. Një person që është i punësuar në territorin e një Pale Kontraktuese dhe që dërgohet nga punëdhënësi i tij në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për të kryer një aktivitet të caktuar në emër të atij punëdhënësi, do të vazhdojë të jetë subjekt i legjislacionit të Palës Kontraktuese të parë gjatë kohës së atij aktiviteti, me kusht që kohëzgjatja e parashikuar e aktivitetit të mos kalojë një periudhë prej 12 muajsh.

2. Një person që është zakonisht i vetëpunësuar në territorin e njërës Palë Kontraktuese dhe që kryen aktivitet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, vazhdon të jetë subjekt i legjislacionit të Palës Kontraktuese të parë, me kusht që kohëzgjatja e parashikuar e këtij aktiviteti të mos kalojë një periudhë prej 12 muajsh.

3. Nëse kohëzgjatja e aktivitetit kalon 12 muaj, me kërkesën e përbashkët të punëmarrësit dhe të punëdhënësit ose të vetëpunësuarit, legjislacioni i Palës së parë Kontraktuese vazhdon të zbatohet për një periudhë maksimale prej 12 muajsh, me pëlqimin e autoritetit kompetent apo të institucionit të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese. Ky pëlqim duhet të kërkohet para skadimit të periudhës fillestare prej 12 muajsh.

Neni 10
Personeli i ndërmarrjeve të transportit ndërkombëtar

1. Një person që është i punësuar nga një ndërmarrje transporti ndërkombëtar, e cila e ka zyrën e saj të regjistruar në territorin e njërës Palë Kontraktuese dhe menaxhon me qira, me shpërblim ose për llogari të vet, shërbime të transportit ndërkombëtar për pasagjerë ose mallra në rrugë hekurudhore, automobilistike, ajrore apo rrugë detare të brendshme, është subjekt i legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese. Megjithatë:

i) një person i punësuar nga një degë apo përfaqësi e përhershme e ndërmarrjes së sipërmendur është subjekt i legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ndodhet kjo degë ose përfaqësi e përhershme;

ii) një person që është i punësuar kryesisht në territorin e Palës Kontraktuese në të cilën banon,

është subjekt i legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese edhe nëse ndërmarrja që e ka punësuar atë nuk ka zyrë të regjistruar, degë apo përfaqësi të përhershme në territorin e saj.

Neni 11
Anëtarët e ekuipazhit të anijeve

Një person që është i punësuar në bordin e një anijeje që lundron me flamurin e një Pale Kontraktuese është subjekt i legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese.

Neni 12
Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore, si dhe personat e punësuar në shërbimin privat të anëtarëve të këtyre misioneve apo zyrave janë subjekt i dispozitave përkatëse të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike, të datës 18 prill 1961 dhe Konventës së Vjenës për marrëdhëniet konsullore, të datës 24 prill 1963.

Neni 13
Përjashtime nga dispozitat e neneve 7 deri 12

Autoritetet kompetente mund të bien dakord për përjashtime nga dispozitat e neneve 7–12 në interes të cilitdo personi ose kategorie personash, me kusht që personi ose personat në fjalë të jenë subjekt i legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese.

PJESA III
DISPOZITA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME KATEGORITË E NDRYSHME TË PËRFITIMEVE

KAPITULLI 1
PËRFITIMET PËR SËMUNDJE DHE BARRËLINDJE

Neni 14
Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Nëse legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon të drejtën për përfitime me plotësimin e periudhave të sigurimit, institucioni kompetent i kësaj Pale Kontraktuese merr parasysh, në masën e nevojshme, periudhat e sigurimit të plotësuara në bazë të legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, në masën që ato nuk mbivendosen, sikur ato të ishin periudha sigurimi të plotësuara sipas legjislacionit të Palës së parë Kontraktuese.

2. Sa i përket lindjes të së drejtës për përfitime në para në rast sëmundjeje dhe barrëlindjeje, bashkimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni bëhet vetëm nëse personi i interesuar ka kryer një punë fitimprurëse në territorin e Palës Kontraktuese ku është bërë aplikimi.

Neni 15
Përfitimet në rast qëndrimi dhe banimi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese

1. Personat që plotësojnë kushtet për lindjen e së drejtës për përfitime sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese dhe gjendja e të cilëve kërkon në mënyrë urgjente dhënien e përfitimeve në natyrë, gjatë qëndrimit apo banimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, marrin përfitime në natyrë, me kusht që shpenzimet përkatëse të mbulohen nga institucioni kompetent sipas dispozitave të legjislacionit që institucioni i vendit të qëndrimit ose të banimit zbaton.

2. Përfitimet në para paguhen nga institucioni kompetent, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që ai zbaton.

Neni 16
Rimbursimi

1. Institucioni kompetent rimburson shumën aktuale të përfitimeve në natyrë, të dhënë në emër të tij, sipas dispozitave të nenit 15 nga institucioni i vendit të qëndrimit apo banimit, përveç shpenzimeve administrative.

2. Shuma aktuale e përfitimeve të kërkuara nga institucioni kompetent për rimbursim llogaritet nga institucioni që jep përfitimet, në nivelin e çmimeve të përdorura për personat e siguruar të vendit të vet.

3. Autoritetet kompetente apo organet ndërlidhëse të të dyja Palëve Kontraktuese mund të bien dakord për rregullime të tjera për rimbursimin e shpenzimeve apo heqjen dorë nga rimbursimi i shpenzimeve ndërmjet institucioneve.

KAPITULLI 2
PËRFITIMET E PLEQËRISË, TË INVALIDITETIT DHE FAMILJAR

Neni 17
Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Kur legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon lindjen e përfitimit me plotësimin e periudhave të sigurimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion merr parasysh, në masën e nevojshme, periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, në masën që ato nuk mbivendosen, sikur ato të ishin periudha të plotësuara në bazë të legjislacionit të Palës së parë.

2. Kur legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon dhënien e përfitimeve të caktuara me plotësimin e një periudhe të caktuar në një profesion të mbuluar nga një skemë e veçantë ose në një profesion apo punësim të veçantë, për përcaktimin e lindjes të së drejtës për këto përfitime, merren parasysh vetëm periudhat e plotësuara në bazë të skemës përkatëse ose në mungesë të një skeme të tillë, periudhat e plotësuara në të njëjtin profesion apo punësim, sipas rastit, në bazë të legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese.

3. Kur legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese parashikon se periudha e pagesës së një pensioni është e vlefshme për përcaktimin e së drejtës për një përfitim, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese, për këtë qëllim, merr parasysh çdo periudhë gjatë së cilës paguhet një pension në bazë të legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 18
Bashkimi i periudhave të sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të një shteti të tretë

Nëse një person nuk fiton të drejtën për një përfitim, duke marrë parasysh periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese, e drejta për këtë përfitim përcaktohet nga bashkimi i këtyre periudhave me periudhat e sigurimit të plotësuara në territorin e një shteti të tretë me të cilin të dyja Palët Kontraktuese kanë një marrëveshje për mbrojtjen shoqërore, e cila parashikon bashkimin e periudhave të sigurimit.

Neni 19
Dhënia e përfitimit dhe llogaritja e tij (llogaritja "pro rata temporis")

1. Kur një person, në vazhdimësi ose ndryshe, ka qenë subjekt i legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese, institucioni i secilës Palë Kontraktuese përcakton, në përputhje me legjislacionin që ai zbaton, nëse ky person apo pasardhësit e tij kanë fituar të drejtën për përfitime, duke pasur parasysh, sipas rastit, dispozitat e nenit 17.

2. Kur personi i interesuar ka fituar të drejtën për përfitime sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese, pa marrë parasysh dispozitat e nenit 17, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese llogarit përfitimet vetëm në bazë të periudhave të plotësuara sipas legjislacionit që zbaton.

3. Kur personi i interesuar ka fituar të drejtën për përfitime sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese, vetëm në përputhje me dispozitat e nenit 17, institucioni kompetent i kësaj Pale Kontraktuese llogarit përfitimet si më poshtë:

a) llogaritet shuma teorike e përfitimeve që do të paguhen sikur të gjitha periudhat të jenë plotësuar në bazë të legjislacionit të zbatuar nga ky institucion;

b) megjithatë, në rastin e përfitimeve, shuma e të cilave nuk varet nga kohëzgjatja e periudhave të plotësuara, kjo shumë merret që të jetë shuma teorike e përmendur në nënparagrafin "a";

c) institucioni kompetent më pas llogarit shumën aktuale të përfitimit që i paguhet personit në fjalë, në bazë të shumës teorike të llogaritur në përputhje me dispozitat e nënparagrafit "a" ose të nënparagrafit "b" të këtij paragrafi, siç është e nevojshme dhe në raport me lidhjen midis periudhave të plotësuara para rastit në fjalë në bazë të legjislacionit që ai zbaton dhe totalit të periudhave të plotësuara para rastit në fjalë në bazë të legjislacioneve të të dyja Palëve Kontraktuese;

d) nëse numri i përgjithshëm i periudhave të plotësuara sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese para rastit në fjalë, e kalon periudhën maksimale të kërkuar nga legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese për marrjen e një përfitimi të plotë, institucioni i asaj Pale Kontraktuese, kur zbaton dispozitat e

nënparagrafit "a" të këtij paragrafi, e merr parasysh këtë periudhë maksimale në vend të totalit të periudhave të specifikuara, sidoqoftë pa qenë i detyruar të japë përfitim më të madh sesa përfitimi i plotë i parashikuar në legjislacionin që zbaton.

4. Kur shuma e përfitimit llogaritet në bazë të numrit të pasardhësve të atij personi, institucioni kompetent merr parasysh pasardhësit që kanë vendbanimin ose qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 20
Periudhat e sigurimit më pak se një vit

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 19, kur kohëzgjatja e përgjithshme e periudhave të sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese është më pak se një vit dhe kur vetëm në bazë të kësaj periudhe nuk ka të drejtë të përfitojë sipas atij legjislacioni, institucioni i asaj Pale Kontraktuese nuk është i detyruar të japë përfitime në lidhje me kohëzgjatjen në fjalë.

2. Periudhat e sigurimit, e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, merren parasysh nga institucioni i Palës tjetër Kontraktuese për qëllime të zbatimit të dispozitave të nenit 19, sikur këto periudha të ishin plotësuar sipas legjislacionit që zbaton, me përjashtim të dispozitave të paragrafit 3/c të nenit 19.

KAPITULLI 3
PËRFITIMET NË RAST AKSIDENTI NË PUNË DHE SËMUNDJEJE PROFESIONALE

Neni 21
Përfitimet në natyrë

1. Përfitimet në natyrë në rast aksidenti në punë dhe sëmundjeje profesionale për personin e siguruar që ka fituar të drejtën e përfitimit, në përputhje me legjislacionin e një Pale Kontraktuese mbulohen nga shpenzimet e institucionit kompetent dhe kryhen nga institucioni i vendit të qëndrimit apo banimit sipas dispozitave të legjislacionit që zbaton.

2. Dhënia e protezave, pajisjeve mjekësore dhe e përfitimeve të tjera thelbësore në natyrë miratohet paraprakisht nga institucioni kompetent, nëse dhënia e përfitimit nuk mund të shtyhet pa rrezikuar seriozisht jetën apo shëndetin e personit në fjalë.

3. Për rimbursimin e kostove aktuale të përfitimeve në natyrë të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohen dispozitat e nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22
Përfitimet në para

Përfitimet në para paguhen nga institucioni kompetent, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që zbaton.

Neni 23
Ekspozimi ndaj të njëjta rasteve në të dyja Palët Kontraktuese

1. Nëse një person i siguruar tek i cili është zhvilluar një sëmundje profesionale, sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese, ka ushtruar një aktivitet që ka gjasa të ketë shkaktuar këtë sëmundje profesionale, përfitimet që vetë personi ose pasardhësit e tij mund të kërkojnë jepen ekskluzivisht sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese të fundit, në territorin e së cilës personi ka ushtruar këtë aktivitet me gjasa të ketë shkaktuar sëmundjen profesionale, madje edhe nëse plotësohen kërkesat e legjislacionit të të dy Palëve Kontraktuese në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2–4 të këtij neni, sipas rastit.

2. Nëse legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon lindjen e së drejtës për përfitime me diagnostikimin e sëmundjes në fjalë së pari në territorin e vet, ky kusht konsiderohet i përmbushur, nëse diagnoza është përcaktuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Nëse legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon lindjen e së drejtës për përfitime me diagnostikimin e sëmundjes në një periudhë të caktuar nga ndërprerja e veprimtarisë profesionale që mund të ketë shkaktuar riskun, institucioni kompetent, nëse është e nevojshme, merr parasysh çdo aktivitet që mund të shkaktojë rreziqe të ngjashme, të kryer sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese.

4. Nëse legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon lindjen e së drejtës për përfitime me kryerjen për një periudhë të caktuar të një aktiviteti që mund të ketë shkaktuar sëmundjen, për llogaritjen e përfitimeve atje, merren, gjithashtu, parasysh periudhat gjatë të cilave

është kryer një aktivitet i tillë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 24

Dhënia e përfitimeve në rast të përkeqësimit të një sëmundjeje profesionale

Nëse sëmundja profesionale e një personi të siguruar, i cili ka marrë apo merr përfitime sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese, përkeqësohet, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) nëse personi në fjalë, sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, nuk ka ushtruar një profesion që mund të shkaktojë apo të përkeqësojë sëmundjen në fjalë, institucioni kompetent i Palës së parë Kontraktuese mbulon koston e përfitimeve, duke marrë parasysh përkeqësimin, në përputhje me legjislacionin që ai zbaton;

b) nëse sëmundja profesionale përkeqësohet si pasojë e kryerjes në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të një veprimtarie që mund të shkaktojë rreziqe të ngjashme, institucioni kompetent i Palës Kontraktuese të parë mbulon koston e përfitimeve, duke mos marrë parasysh përkeqësimin, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që zbaton. Institucioni kompetent i Palës tjetër Kontraktuese jep një shtesë për personin, shuma e së cilës është e barabartë me diferencën e vlerës së përfitimeve pas përkeqësimit dhe vlerës së përfitimeve që do të jepeshin përpara përkeqësimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që zbaton, nëse sëmundja përkatëse do të ishte shkaktuar në bazë të legjislacionit të kësaj Pale Kontraktuese.

KAPITULLI 4
PAGESA PËR VDEKJE

Neni 25

Bashkimi i periudhave të sigurimit dhe dhënia e pagesave për vdekje

1. Nëse legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese e kushtëzon lindjen e së drejtës për përfitime me plotësimin e periudhave të sigurimit, institucioni kompetent i asaj Pale Kontraktuese, merr parasysh në masën e kërkuar periudhat e sigurimit të plotësuara në bazë të legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, në masën që ato nuk mbivendosen, sikur të ishin periudha të plotësuara sipas legjislacionit të Palës së parë Kontraktuese.

2. Nëse njihet e drejta për një pagesë për vdekje sipas legjislacionit të të dyja Palëve Kontraktuese, pagesa për vdekje paguhet vetëm në bazë të legjislacionit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ka ndodhur vdekja.

3. Nëse vdekja nuk ndodh në territorin e njërës Palë Kontraktuese, pagesa për vdekje kryhet nga institucioni ku personi është siguruar së fundmi para vdekjes.

PJESA IV
DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 26

Masat administrative dhe të bashkëpunimit

1. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese vendosin nëpërmjet Marrëveshjes administrative masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese përcaktojnë në Marrëveshjen Administrative organet ndërlidhëse, të cilat do të ndihmojnë lehtësimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese i komunikojnë njëra-tjetra, në një kohë sa më të shpejtë, të gjithë informacionin në lidhje me masat e marra nga ana e tyre për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ose rreth ndryshimeve në legjislacionin e tyre kombëtar në masën që këto ndryshime ndikojnë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4. Autoritetet kompetente dhe institucionet e të dyja Palëve Kontraktuese ndihmojnë njëra-tjetrën për çdo çështje që lidhet me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Kjo ndihmë jepet pa pagesë.

5. Nëse një person që banon ose qëndron në territorin e njërës Palë Kontraktuese ka kërkuar apo merr përfitim sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese dhe nëse është e nevojshme një ekspertizë mjekësore, institucioni i vendit të banimit ose të qëndrimit të Palës së parë Kontraktuese merr masa për këtë ekspertizë me kërkesë dhe me shpenzimet e institucionit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 27

Përdorimi i gjuhëve zyrtare

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet dhe institucionet e Palëve Kontrak-

tuese mund të komunikojnë me njëra-tjetrën drejtpërdrejt në gjuhët e tyre zyrtare ose në gjuhën angleze.

2. Nuk do të refuzohet asnjë kërkesë apo dokument me arsyetimin se është shkruar në gjuhën zyrtare të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 28
Përjashtimi nga tarifat dhe vërtetimi

1. Nëse legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese parashikon përjashtimin tërësisht ose pjesërisht nga tarifat ligjore, taksat konsullore apo detyrimet administrative, ky përjashtim zbatohet për certifikatat apo dokumentet e ngjashme të lëshuara nga autoritetet e Palës tjetër Kontraktuese për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

2. Të gjitha deklaratat, dokumentet dhe certifikatat e çdo lloji që kërkohet të prodhohen për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, njihen reciprokisht nga të dyja Palët Kontraktuese në mënyrën që ato janë lëshuar nga autoritetet përkatëse dhe përjashtohen nga vërtetimi nga ana e autoriteteve diplomatike ose konsullore.

Neni 29
Dorëzimi i një kërkese, njoftimi apo ankese

1. Kërkesat, njoftimet apo ankesat të cilat, sipas legjislacionit të njërës Palë Kontraktuese, duhet të dorëzohen brenda një periudhe të caktuar kohe te një autoritet apo institucion i kësaj Pale Kontraktuese, e përmbushin këtë kusht, nëse dorëzohen brenda të njëjtës periudhë tek autoritetet apo institucionet përkatëse të Palës tjetër Kontraktuese. Në këtë rast, autoriteti apo institucioni që ka marrë kërkesat, njoftimet apo ankesat i dërgon ato pa vonesë tek autoriteti apo institucioni i Palës së parë Kontraktuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet organeve ndërlidhëse të Palëve Kontraktuese.

2. Kërkesat, njoftimet apo ankesat sipas legjislacionit të një Pale Kontraktuese konsiderohen kërkesa, njoftime apo ankesa për përfitimet perkatëse, sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese.

3. Data kur këto kërkesa, njoftime apo ankesa i dorëzohen një autoriteti ose institucioni të Palës tjetër Kontraktuese konsiderohet të jetë data e dorëzimit tek autoriteti apo institucioni që ka të drejtën e pranimit të këtyre kërkesave, njoftimeve apo ankesave.

Neni 30
Rikthimi i pagesave të tepërta

Kur institucioni i një Pale Kontraktuese ka paguar përfitime për një përfitues në një shumë që kalon atë për të cilën ai/ajo kishte të drejtë, ky institucion, siç parashikohet nga legjislacioni që zbaton, mund t'i kërkojë institucionit të Palës tjetër Kontraktuese që duhet t'i paguajë përfitimet në para përfituesit, të zbresë shumën e tepërt nga shumat që duhet t'i paguhen përfituesit në fjalë. Institucioni i fundit zbret shumën sipas kërkesave dhe kufizimeve, në bazë të të cilave ky kompensim është autorizuar nga legjislacioni që zbaton, sikur këto shuma të ishin paguar më tepër nga ai vetë dhe e transferon shumën e zbritur tek institucioni aplikues.

Neni 31
Procedurat e zbatimit

1. Vendimet gjyqësore të njërës Palë Kontraktuese, si dhe dokumentet e lëshuara nga një autoritet apo institucion i njërës Palë Kontraktuese në lidhje me kontributet e mbrojtjes shoqërore, si dhe kërkesat e tjera njihen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Njohja mund të refuzohet vetëm nëse është në kundërshtim me rendin publik të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës kërkohet njohja e vendimit ose e dokumentit.

3. Vendimet e marra dhe dokumentet e njohura sipas paragrafit 1 të këtij neni zbatohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Procedura e zbatimit do të jetë në përputhje me legjislacionin në territorin e të cilit bëhet zbatimi.

4. Kontributet e papaguara në institucionin e njërës Palë Kontraktuese, në çdo procedurë falimentimi apo përmbarimi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kanë përparësi të njëjtë, si dhe borxhet ekuivalente në territorin e asaj Pale Kontraktuese.

Neni 32
Monedha e pagesës

1. Pagesa e çdo përfitimi sipas kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet në monedhën e Palës Kontraktuese, institucioni i së cilës jep përfitimet.

2. Nëse një përfitues kërkon që përfitimet t'i paguhen në një monedhë tjetër dhe jo në monedhën zyrtare të Palës Kontraktuese, institucioni kompetent i së cilës paguan përfitimet,

risku i këmbimit është kostoja që mbulohet nga përfituesit në fjalë.

3. Monedha dhe metodat e pagesës për shumat që përfaqësojnë rimbursimet e përfitimeve ndërmjet institucioneve vendosen me Marrëveshje Administrative.

Neni 33
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me konsultim ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese.

2. Nëse mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ato zgjidhen nga Palët Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 34
Shkëmbimi i të dhënave personale

1. Institucionet e të dyja Palëve Kontraktuese autorizohen për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për të shkëmbyer të dhënat personale, duke përfshirë edhe të dhënat në lidhje me të ardhurat e personave që institucioni i njërës Palë Kontraktuese ka nevojë për zbatimin e legjislacionit të vet.

2. Në komunikimin e këtyre të dhënave, institucioni i një Pale Kontraktuese respekton ligjet dhe rregulloret që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale të kësaj Pale Kontraktuese.

3. Ruajtja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave personale nga institucioni i Palës Kontraktuese, kur këto të dhëna janë komunikuar, rregullohen me ligje dhe rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale të kësaj Pale Kontraktuese.

4. Të dhënat e përmendura në këtë nen konsiderohen konfidenciale dhe përdoren ekskluzivisht për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

PJESA V
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 35
Dispozita kalimtare

1. Kjo Marrëveshje nuk jep asnjë të drejtë për ndonjë periudhë para hyrjes së saj në fuqi.

2. Të gjitha periudhat e sigurimit të plotësuara në bazë të legjislacionit të një Pale Kontraktuese para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje merren parasysh në funksion të përcaktimit të të drejtave që lindin në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

3. Në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, një e drejtë mund të lindë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, madje edhe në lidhje me një rast që ka lindur para hyrjes së saj në fuqi.

4. Çdo përfitim që është vendosur para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk rillogaritet.

Neni 36
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore nga data e njoftimit më të fundit, nëpërmjet të cilit Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Konventa ndërmjet qeverisë së Republikës Popullore të Rumanisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë për bashkëpunimin në fushën e çështjeve sociale, e nënshkruar në Bukuresht, më 3 maj 1961, shfuqizohet.

Neni 37
Kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar.

2. Secila nga Palët Kontraktuese mund ta denoncojë atë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër Kontraktuese, të paktën gjashtë muaj para fundit të vitit kalendarik përkatës. Marrëveshja shfuqizohet duke filluar nga dita e parë e vitit të ardhshëm kalendarik.

Neni 38
Efektet mbi të drejtat e fituara ose për t'u fituar

1. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, ruhen të drejtat për përfitime të fituara në bazë të dispozitave të saj.

2. Të drejtat për përfitime në procesin e njohjes se tyre, sipas periudhave para përfundimit

të kësaj Marrëveshjeje ruhen dhe kërkesat e paraqitura para përfundimit të kësaj Marrëveshjeje përcaktohen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Bukuresht, më 27 shkurt 2015, në dy kopje origjinale, secila prej tyre në gjuhën shqipe, rumune dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të mospërputhjeve në interpretimi, do të ketë përparësi versioni në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr. 44/2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9355, DATË 10.3.2005, "PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 6, 7 dhe 11 ndryshohen si më poshtë:

"6. Bashki/njësi administrative" është institucioni, nën juridiksionin e të cilit subjektet përfituese, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar kompensimin e të ardhurave materiale ose/dhe monetare, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe shërbime shoqërore.

7. "Administrator shoqëror" është nëpunësi civil i organeve të pushtetit vendor, i cili vlerëson, verifikon e administron procesin dhe dokumentacionin për aplikimin e përfitimin e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët në nevojë, nëpërmjet përdorimit të regjistrit elektronik kombëtar.

11. "Familje në nevojë" është familja që nuk ka të ardhura ose ka të ardhura të pamjaftueshme nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera.".

2. Pika 12 shfuqizohet.

3. Në fund të pikës 13 shtohen fjalët "dhe të familjes në nevojë, sipas pikës 4 të nenit 19.".

4. Në pikën 14, fjalët "pa prindër" shfuqizohen.

5. Pikat 20, 21 dhe 30 shfuqizohen.

6. Pas pikës 31 shtohen pikat 32, 33, 34 dhe 35 me këtë përmbajtje:

"32. "Formula e unifikuar e pikëzimit" është një formulë e pranueshmërisë së familjeve për ndihmë ekonomike, duke përdorur koeficientë dhe ndryshore të përcaktuara qartë, të cilët dalin nga lidhjet reciproke, objektive, me statusin ekonomik dhe me varfërinë.

33. "Vlerësimi biopsikosocial" është një proces vlerësimi i faktorëve të ndryshëm dhe të ndërvarur, të cilët dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët. Këta faktorë janë: struktura trupore, funksionet trupore e psikologjike, si dhe faktorë personalë, shoqërorë, ekonomikë dhe kulturorë.

34. "Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar" është një ekip i përzgjedhur, me mjek dhe punonjës social/psikolog, të cilët janë të punësuar pranë drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe janë përgjegjës për procesin e vlerësimit biopsikosocial të aplikuesve për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga mjekët, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara dhe verifikimin e informacionit me institucione të tjera.

35. "Ri/integrimi social" është tërësia e veprimtarive të integruara në pagesa dhe shërbime, që synojnë fuqizimin ekonomik të përfituesve të ndihmës ekonomike nëpërmjet punësimit.".

Neni 2

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6

Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë, deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, gratë, vajzat në nevojë, azilkërkuesit e mitur, të

pashoqëruar, për efekt të përfitimit të shërbimit të kujdestarisë, sipas përcaktimeve të nenit 15, të këtij ligji, si dhe të gjithë ata që janë në rrezik të bëjnë pjesë në grupet në nevojë.”.

Neni 3

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ndihma ekonomike është një pagesë e kufizuar në kohë, që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave. Masat përjashtuese nga skema e ndihmës ekonomike për familjet, të cilat nuk zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike vlerësohen sipas nevojave dhe mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke u dhënë pesha specifike të qarta, objektive e transparente, si pjesë e një formule të pikëzuar. Kriteret dhe detajet e formulës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Rishikimi i parametrave të programeve të ndihmës ekonomike, duke përfshirë rishikimin e kritereve të vlerësimit për ndihmën dhe aftësinë e kufizuar dhe përditësimin e formulës së unifikuar të pikëzimit, e cila ndihmon në përcaktimin e kritereve të pranueshmërisë së familjeve për përftimin e ndihmës ekonomike, bazuar në ndryshimin e nivelit të varfërisë në vend, realizohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.”.

3. Pika 3 shfuqizohet.

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Masa mujore e ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes, procedurave, dokumentacionit dhe kritereve që duhet të plotësojnë familjet dhe individët në nevojë për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Në nenin 11, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 48 muajve punësimi. Procedurat në rastet e rikthimit në skemën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 19 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Fjalia e parë dhe pika 1 ndryshohen si më poshtë:

“Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë.

1. Ndihmë ekonomike të plotë përfitojnë familjet ose individët që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera.”.

2. Pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

Neni 6

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj, me vendim të strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Bashkia/njësia administrative njofton kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit për vendimin e drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet publikimit të tij, dhe kryen veprimet financiare për pagesën.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Pagesa e personave me aftësi të kufizuar shpërndahet një herë në muaj, me vendim të këshillit bashkiak.”.

Neni 7

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga

sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror. Këto familje në nevojë do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind dhe/ose me fonde të buxhetit vendor, sipas përcaktimeve që do të bëhen nga ministri përgjegjës për çështjet sociale.".

Neni 8

Neni 25 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 26, pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

Neni 10

Në nenin 27 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2, fjalët "Statusi i Shërbimit Social Shtetëror" zëvendësohen me fjalët "Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit Social Shtetëror".

2. Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

3. Në pikën 5 bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën "c", pas fjalës "përcaktimin" shtohet shtohen fjalët "dhe miratimin".

b) Pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

"e) kontrollin e veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe pranë pushtetit vendor, për ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Procedura e kryerjes së kontrollit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 11

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 27/1

Strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për ndihmën ekonomike, kanë këto përgjegjësi:

1. Verifikimin e të dhënave të regjistruara nga administratori shoqëror në regjistrin kombëtar elektronik të të dhënave dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse për familjet/individët në nevojë, të cilët janë propozuar me vendim të këshillit bashkiak, që të trajtohen me ndihmë ekonomike.

2. Vendimmarrjen për:

a) caktimin e familjes/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, që plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe masën e përfitimit të tyre. Për familjen në proces zgjidhjeje martese, kur nuk ka ende një vendim të formës së prerë, masa e përfitimit caktohet e ndarë për të dy bashkëshortët;

b) refuzimin e kërkesës për caktimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për familjet/individët në nevojë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Dërgimin e vendimit, për rastet e parashikuara në shkronjat "a" e "b", të pikës 2, të këtij neni, kryetarit të bashkisë:

a) për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;

b) për të kryer veprimet financiare për pagesën, për përfituesit e ndihmës ekonomike.".

Neni 12

Në nenin 29 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Merr vendimin për propozimin që familja/ individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse të përfitimit. Ky vendim i përcillet menjëherë, zyrtarisht, strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.".

2. Pikat 7, 9, 10 dhe 11 shfuqizohen.

Neni 13

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 30/1

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, për efekt të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, kryen këto detyra:

1. Harton projektvendimin për familjet/ individët në nevojë, nën juridiksionin e bashkisë, për trajtim me ndihmë ekonomike dhe përllogarit fondin për mbulimin e tyre.

2. Paraqet në këshillin bashkiak projektvendimin për propozimin për familjet/individët në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe masën e përfitimit për këto familje/individë në nevojë.

3. Harton projektvendimin për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar;

4. Harton kërkesën për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuar.

5. Grumbullon dhe përgatit informacione e statistika, të cilat i dërgon pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, mban regjistrin e përfituesve dhe ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar.".

Neni 14

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat "b" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"b) të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dy herë në vit dhe, për familjet që shpallen përfituese për herë të parë, verifikimi i parë të kryhet brenda tre muajve;

c) të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki të dhënat për familjet/individët në nevojë, që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe personat që do të trajtohen me shërbime të përkujdesjes shoqërore;".

2. Në shkronjën "ç", në fund të fjalisë shtohen fjalët "si edhe të administrojë këtë dokumentacion".

3. Shkronjat "d" dhe "dh" shfuqizohen.

4. Pas shkronjës "gj" shtohen shkronjat "h", "i" dhe "j" me këtë përmbajtje:

"h) të hedhin në regjistrin elektronik kombëtar të dhënat e deklaruara nga aplikuesit për ndihmë ekonomike;

i) të kontribuojnë në procesin e hartimit të projektvendimit për propozimin që familja /individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe të listës së personave me aftësi të kufizuar;

j) të raportojnë pranë bashkisë të dhëna statistikore për numrin dhe fondin për familjet /individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar.".

Neni 15

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 36

Ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore transferon çdo dy muaj fondin e bllok-ndihmës ekonomike në bashki.".

Neni 16

Në nenin 41, pika 1, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 27/1, 30/1 dhe 31, të këtij ligji, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë vepër penale:".

Neni 17

Neni 41/1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 41/1
Ankimi

1. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund të paraqesë ankesë, me shkrim, pranë bashkisë/njësisë administrative, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton, me shkrim, ankuesin, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 10 ditëve pune, nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.".

Neni 18

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 42
Dispozita kalimtare

1. Përdorimi i regjistrit elektronik kombëtar të të dhënave për aplikuesit dhe përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të

përkujdesjes shoqërore do të pilotohet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat nuk do të kryhet pilotimi, do të zbatohet legjislacioni në fuqi për aftësinë e kufizuar dhe shërbimet shoqërore.".

Neni 19

Nenet 42/1 dhe 42/2 shfuqizohen.

Neni 20

Shtohen nenet 42/3, 42/4 dhe 42/5 me këtë përmbajtje:

"Neni 42/3

Në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat do të kryhet pilotimi i regjistrit elektronik kombëtar dhe modeli biopsikosocial i vlerësimit të aftësisë së kufizuar me grup/komision vlerësimi shumë-disiplinor, për të gjithë personat, të cilët kërkojnë të vlerësohen/rivlerësohen për aftësinë e kufizuar, do të ndiqen këto procedura:

1. Kërkesa dhe dokumentacioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar paraqiten pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, e cila hedh të dhënat e aplikuesit në regjistrin elektronik kombëtar, administron dokumentacionin, kryen verifikimin dhe vlerësimin e individëve dhe merr vendimin për aftësinë e kufizuar.

2. Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror pajis me dokumentin përkatës personin me aftësi të kufizuar dhe i dërgon kryetarit të bashkisë vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar, për të kryer veprimet financiare.

3. Masa, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe ndihmësit personal, si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 42/4

1. Regjistri elektronik kombëtar për aplikuesit dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore do të pilotohet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për përfitimin e shërbimeve shoqërore përcaktohen me vendime të Këshillit të Ministrave.

Neni 42/5

1. Familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike, të përcaktuar në nenin 5, të këtij ligji, të cilët janë në moshë pune, përfshihen në programe të ri/integrimit social.

2. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë personat që do të përfshihen në programe të ri/integrimit social përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Miratimi i programeve të ri/integrimit social bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 21

Kudo në ligj, emërtimi "Këshilli i Bashkisë/ Komunës" zëvendësohet me emërtimin "Këshilli bashkiak"; emërtimi "komunë" zëvendësohet me emërtimin "njësi administrative"; emërtimet "Njësi e qeverisjes vendore" dhe "organe të qeverisjes vendore" zëvendësohen me emërtimin "Njësi e vetëqeverisjes vendore".

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 shtator 2016.

Miratuar në datën 21.4.2016

Shpallur me dekretin nr. 9578, datë 5.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 268, datë 6.4.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, çdo akt nënligjor që vjen në kundërshtim me këtë rregullore, shfuqizohet.

3. Ngarkohen anëtarët e Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

RREGULLORE
PËR FUNKSIONIMIN E
KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim vendosjen e rregullave të përgjithshme dhe përcaktimin e procedurave me anë të të cilave Këshilli Kombëtar i Ujit përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Neni 2
Objekti

Rregullorja ka për objekt organizimin, funksionimin dhe administrimin e Këshillit Kombëtar të Ujit, si dhe marrëdhëniet me organet shtetërore, entet publike, subjektet private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e ujit.

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Akt", lloji i vendimit me karakter të përgjithshëm ose individual që merr Këshilli Kombëtar i Ujit.

2. "Autorizim", akti administrativ, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.

3. "Detyrë", funksione, detyrime që i ngarkohen Këshillit Kombëtar të Ujit, nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave ose Kryeministri, për dhënien e mendimeve apo rekomandimeve në fushën e menaxhimit dhe administrimit të ujit.

4. "Kompetencë", të drejtat që i janë dhënë me ligj Këshillit Kombëtar të Ujit për të vendosur, zgjidhur për një rreth të caktuar çështjesh në fushën e administrimit të burimeve ujore.

5. "Komitet ndërministror", organi konsultativ i Këshillit të Ministrave, ku diskutohen paraprakisht politikat, çështjet e rëndësishme të veprimtarisë ekzekutive, si dhe projektaktet e një rëndësie të veçantë.

6. "Koncesion", marrëveshja ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, sipas përcaktimit në ligjin për koncesionet.

7. "Leje", akti administrativ, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

8. "Ministri përgjegjës", ministri i cili, me vendim të Këshillit të Ministrave, është caktuar anëtar i Këshillit Kombëtar të Ujit dhe propozon aktin në përputhje me fushën e përgjegjësisë shtetërore.

9. "Ministria", njësia administrative organizative brenda së cilës ushtron veprimtarinë e tij ministri përgjegjës.

10. "Nismë propozuese", ushtrimi i së drejtës ligjore për të hartuar dhe propozuar miratimin e akteve nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

11. "Sekretariati Teknik", Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.

12. "Projektakti", projektvendimi me karakter të përgjithshëm ose individual që paraqitet për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Ujit.

13. "Vendim me karakter individual", akti nënligjor i Këshillit Kombëtar të Ujit, i cili rregullon një marrëdhënie konkrete ose u drejtohet një ose disa subjekteve, individualisht të përcaktuara.

14. "Vendim me karakter normativ", akti nënligjor i Këshillit Kombëtar të Ujit, i cili rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 4
Organizimi i Këshillit Kombëtar të Ujit

1. Këshilli Kombëtar i Ujit është organ ndërministror dhe kryesohet nga Kryeministri.

2. Përbërja e Këshillit Kombëtar të Ujit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5
Kompetencat dhe detyrat

1. Kompetencat e Këshillit Kombëtar të Ujit janë të përcaktuara në ligj.
2. Këshilli Kombëtar i Ujit ushtron dhe detyra të tjera të përcaktuara me akte nënligjore.

Neni 6
Kryetari

1. Kryetari ushtron edhe këto detyra:
a) Përfaqëson Këshillin Kombëtar të Ujit;
b) Ngarkon me detyra anëtarët për dhënien e mendimeve, vlerësimeve apo rekomandimeve në fushën e menaxhimit dhe administrimit të ujit;
c) Urdhëron ngritjen e grupeve të punës për trajtimin dhe kryerjen e detyrave komplekse në fushën e menaxhimit të ujit;
ç) Pezullon zbatimin e akteve të ministrave, të drejtuesve të institucioneve qendrore, në varësi të tij ose të ministrave, me nismën e vet ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, kur konstaton shkelje të Kushtetutës, të ligjeve, të akteve të Këshillit të Ministrave ose të akteve të Këshillit Kombëtar të Ujit;
d) Zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave për bashkërendimin e projektakteve të propozuara për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit.
2. Me miratimin e Këshillit Kombëtar të Ujit, Kryetari mund të marrë përsipër edhe detyra të tjera.

KREU III
PROPOZIMI I AKTIT

Neni 7
Nisma propozuese

1. Nisma për propozimin e aktit për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit ushtrohet nga Kryetari, zëvendëskryeministri, anëtarët, Sekretari Kombëtar i Ujit, këshillat e baseneve ujore, institucionet e tjera qendrore në varësi të Kryeministrit ose ministrit.
2. Kryetari dhe zëvendëskryeministri e ushtron këtë të drejtë në çdo rast, kryesisht dhe/ose kur kjo e drejtë nuk është ushtruar nga ministri përgjegjës.
3. Anëtarët e ushtrojnë këtë të drejtë në përputhje me fushat e veprimtarisë shtetërore që kanë në kompetencë, si dhe me përgjegjësitë që burojnë nga strategjitë dhe dokumentet e tjera të miratuara për drejtimet kryesore të politikës së menaxhimit të ujit.
4. Nisma për propozimin e projektaktit, kur fusha e marrëdhënieve që rregullon lidhet me veprimtari të cilat janë në kompetencë të më shumë se një ministri, ushtrohet bashkërisht nga ministrat përgjegjës.
5. Sekretari Kombëtar i Ujit e ushtron këtë të drejtë sipas kompetencave të dhëna në aktet ligjore dhe nënligjore për menaxhimin e burimeve ujore.
6. Këshillat e baseneve ujore e ushtrojnë këtë të drejtë sipas kompetencave me aktet ligjore e nënligjore, nëpërmjet Sekretariatit Teknik.
7. Projektaktet, që u përkasin institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, propozohen nëpërmjet Kryetarit ose ministrit përgjegjës.

Neni 8
Përgatitja e projektaktit

1. Projektakti së bashku me dokumentacionin shoqërues përgatitet nga strukturat përgjegjëse të ministrisë, duke ndjekur të njëjtën procedurë hartimi, siç përcaktohet në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", të ndryshuar.
2. Ministri përgjegjës ia dërgon projektaktin së bashku me dokumentacionin shoqërues, të referuar në pikën 1 të këtij neni, për mendim paraprakisht Sekretariatit Teknik dhe pasi bien dakord ndërmjet tyre ua dërgon për mendim anëtarëve të tjerë të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe institucioneve të tjera të interesuara.
3. Secili nga anëtarët ia dërgon mendimin e tij për projektaktin ministrit propozues në formë shkresore, jo më vonë se 7 ditë pune nga data e marrjes së tij.
4. Në rastin e dhënies së mendimeve që synojnë të propozojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht përmbajtjen e projektaktit, ministri propozues mund të vendosë tërheqjen e plotë ose të pjesshme të propozimit ose të ndryshojë projektaktin duke pasqyruar riformulimet e nevojshme.
5. Në rastin e propozimeve që synojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht thelbin e përmbajtjes së projektaktit,

ministri propozues organizon konsultime me ministrat përkatës për bashkërendimin e propozimit.

6. Projektakti, i cili ka pasqyruar vërejtjet dhe sugjerimet e ministrave dhe të titullarëve të institucioneve të tjera të interesuara, u dërgohet dhe një herë për mendim anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Ujit.

7. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e anëtarëve të tjerë dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim pranë Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.

8. Për institucionet në varësi të Kryeministrit, bashkërendimi institucional udhëhiqet nga Sekretari Kombëtar i Ujit. Për institucionet e tjera qendrore në varësi të ministrit, bashkërendimi institucional udhëhiqet nga ministri.

9. Propozimet e këshillave të baseneve ujore bashkërendohen nga Sekretari Kombëtar i Ujit.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rastin kur për projektaktin nuk është arritur bashkërendimi ndërmjet ministrive, Sekretari Kombëtar i Ujit vendos dërgimin e tij për shqyrtim Kryetarit, duke i bashkëlidhur një relacion shpjegues teknik për përmbajtjen, problematikën si dhe zgjidhjen e mundshme të sugjeruar lidhur me kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet e evidentuara.

2. Procedura e pikës 1 ndiqet dhe në rastet kur nuk arrihet bashkërendimi ndërmjet ministrit propozues apo ministrave të tjerë me Sekretariatin Teknik.

3. Kryetari urdhëron sipas rrethanave:

a) thirrjen në konsultë të ministrave të interesuar, Sekretarit Kombëtar të Ujit dhe personave të tjerë që çmohen prej tij, përpara se të marrë vendimin përkatës;

b) delegimin e zgjidhjes së çështjes zëvendëskryeministrit ose Sekretarit Kombëtar të Ujit, kur thelbi i kundërshtive lidhet vetëm me çështje të ligjshmërisë. Së bashku me delegimin, Kryetari cakton edhe modalitete dhe afatet përkatëse të kësaj procedure dhe për raportin e rezultateve që duhet t'i paraqiten për miratim;

c) dërgimin e projektaktit për shqyrtim dhe konsultim më të gjerë në Komitetin Ndërministror.

4. Në rastin e shkronjës "b", të pikës 3, të këtij neni, autoriteti i deleguar organizon konsultimin me pjesëmarrjen e ministrave të interesuar dhe funksionarëve të tjerë politikë. Në përfundim të konsultimit, autoriteti i deleguar i raporton me shkrim Kryetarit duke propozuar për miratim ose vendimmarrje zgjidhjet eventuale të çështjes.

5. Sipas urdhrit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga Kryetari, ministri propozues i reflekton ato në bashkëpunim me Sekretariatin Teknik dhe paraqet projektin e ripunuar, së bashku me dokumentacionin shoqërues, për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit.

Neni 10

Planet, projektet ndërrajonale dhe kombëtare

1. Propozimi për miratimin e projekteve ndërrajonale dhe kombëtare me interes publik paraqitet në Këshillin Kombëtar të Ujit nga ministri përgjegjës për fushën e veprimtarisë shtetërore. Ministri propozues ia dërgon projektin paraprakisht për mendim Sekretariatit Teknik dhe më pas anëtarëve të tjerë të Këshillit Kombëtar të Ujit.

2. Pas marrjes së mendimit nga të gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit Kombëtar të Ujit, kërkesa, e shoqëruar me mendimet e anëtarëve dhe me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, depozitohet pranë Sekretariatit Teknik .

3. Pas miratimit të projektaktit në Këshillin Kombëtar të Ujit, ministri propozues, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ndjek procedurën për miratimin në Këshillin e Ministrave ose për zbatimin e drejtpërdrejtë.

Neni 11

Kërkesa për autorizim, leje për përdorim burimi ujor

1. Subjekti i interesuar depoziton pranë Sekretariatit Teknik kërkesën për dhënie lejeje, autorizim për përdorim të burimit ujor, në rastet kur miratimi i tyre është kompetencë e Këshillit Kombëtar të Ujit

2. Kërkesa shoqërohet me të gjithë dokumentacionin teknik e ligjor të kërkuar, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore.

Neni 12
Kërkesa për "miratimin në parim" për dhënie koncesioni

1. Kërkesa për "miratimin në parim" për dhënie me koncesion të burimeve ujore paraqitet nga ministri përgjegjës për fushën e veprimtarisë shtetërore.

2. Kërkesa, përpara se të drejtohet për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit, u dërgohet për mendim të gjithë anëtarëve nga ministri propozues.

3. Pas bashkërendimit të propozimit me anëtarët e tjerë të Këshillit Kombëtar të Ujit, kërkesa, e shoqëruar me mendimet e të gjithë anëtarëve si dhe me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore e të koncesioneve, depozitohet pranë Sekretariatit Teknik.

KREU IV
SHQYRTIMI I PROJEKTAKTEVE NGA SEKRETARIATI TEKNIK

Neni 13
Shqyrtimi i projektaktit

1. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin me dokumentacionin shoqërues për shqyrtim pranë Sekretariatit Teknik.

2. Në rastin kur Sekretariati Teknik ka vërejtje apo sugjerime lidhur me përmbajtjen e projektaktit, ky mendim i dërgohet ministrit propozues brenda 15 ditëve pune nga data e shqyrtimit të tij.

a) Ministri propozues brenda 10 ditëve pune njofton në formë shkresore Sekretariatin Teknik, lidhur me qëndrimin e tij për vërejtjet dhe sugjerimet.

b) Në rastet kur ministri propozues nuk është dakord me vërejtjet dhe sugjerimet e Sekretariatit Teknik, atëherë ndiqet procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjes sipas nenit 10 të rregullores.

3. Sekretari Kombëtar i Ujit, për qartësimin e aspekteve teknike të përmbajtjes së projektaktit, thërret në konsultë përfaqësues të strukturave juridike dhe teknike të ministrisë propozuese.

Neni 14
Shqyrtimi i autorizimit, lejes për përdorim burimi ujor

1. Sekretariati Teknik shqyrton të gjithë dokumentacionin teknik e ligjor të paraqitur nga subjekti i interesuar, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore.

2. Sekretariati Teknik kërkon plotësimin e dokumentacionit në rastin kur nuk është i plotë.

Kërkesat për marrje autorizimi ose leje për përdorim uji paraqiten në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Ujit vetëm pasi subjekti kërkues ka plotësuar dokumentacionin teknik dhe ligjor në përputhje me legjislacionin në fushën e menaxhimit të burimeve ujore.

Neni 15
Korrigjimi

Sekretariati Teknik mund të korrigjojë projektaktin në drejtim të terminologjisë së përdorur, por në asnjë rast nuk cenon thelbin e tij.

Neni 16
Kthimi i projektaktit

Sekretari Kombëtar i Ujit vendos kthimin e arsyetuar të projektaktit, ministrit propozues, kur:

a) nuk janë respektuar kërkesat e nenit 9 të kësaj rregulloreje;

b) projektakti nuk është në pajtim me Kushtetutën, vjen në kundërshtim ose nuk është në harmoni me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e brendshëm;

c) mangësitë e projektaktit, veçanërisht ato me përmbajtje voluminoze, nga pikëpamja e teknikës legjislative, janë shumë të dukshme dhe të pranishme gjatë gjithë përmbajtjes së tij.

Neni 17
Relacioni teknik dhe ligjor

Sekretariati Teknik përgatit një relacion teknik dhe ligjor për çdo propozim të paraqitur për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit.

KREU V
ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I MBLEDHJES

Neni 18
Rendi i ditës

1. Sekretari Kombëtar i Ujit, në bazë të propozimeve dhe të çështjeve të paraqitura, përgatit rendin e ditës së mbledhjes dhe ia propozon për miratim Kryetarit.
2. Rendi i ditës përmban:
a) tematikën që do të trajtohet;
b) propozimet që do të shqyrtohen;
c) problemet e ndryshme që do të diskutohen.
3. Kryetari mund ta ndryshojë ose të përfshijë në rendin e ditës dhe çështje të cilat nuk janë propozuara nga Sekretari Kombëtar i Ujit.

Neni 19
Thirrja e mbledhjes

1. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjes.
2. Sekretari Kombëtar i Ujit njofton anëtarët e Këshillit Kombëtar të Ujit për rendin e ditës, datën dhe orën e mbledhjes.
3. Çdo ndryshim në datën dhe orën e vendosur për mbledhjet u njoftohet anëtarëve në mënyrë që të njihen me këto ndryshime.
4. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Në këtë rast, lajmërimi për thirrjen e mbledhjes bëhet brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës.
5. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret nga Kryetari. Në pamundësi të Kryetarit, thirret nga Zëvendëskryeministri.

Neni 20
Organizimi

1. Sekretariati Teknik organizon punën për përgatitjen e mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Ujit.
2. Anëtarëve u vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ministri propozues, si dhe relacioni teknik e ligjor i Sekretariatit Teknik për çdo propozim.
3. Anëtarët, si rregull vihen në dijeni për rendin e ditës të shoqëruar me materialin përkatës, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar për thirrjen e mbledhjes.
4. Për mbledhjet e jashtëzakonshme rendi i ditës dhe materialet shpërndahen jo më vonë se 2 orë përpara orës së caktuar për mbledhje.

Neni 21
Pjesëmarrja

1. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se 50% e anëtarëve të Këshillit, një prej të cilëve duhet të jetë Kryetari ose zëvendëskryeministri.
2. Kur për shkaqe të arsyeshme ministri nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë në vend të tij merr pjesë, pa të drejtë vote, zëvendësministri.
3. Sekretari Kombëtar i Ujit merr pjesë rregullisht në mbledhje, pa të drejtë vote.
4. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm më shumë se 50% e anëtarëve, drejtuesi vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, jo më pak se 24 orë pas të parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm më shumë se 50% e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 22
Kryesimi dhe drejtimi

1. Mbledhja kryesohet dhe drejtohet nga Kryetari.
2. Në mungesë të Kryetarit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryeministri.

Neni 23
Zhvillimi i mbledhjes

1. Mbledhja bëhet me dyer të mbyllura.
2. Me propozim të Kryetarit mbledhjet bëhen me dyer të hapura. Në këtë rast Sekretariati Teknik merr masa për njoftimin e palëve të interesuara. Ky njoftim bëhet të paktën 2 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Për arsye të motivuara, me propozim të Kryetarit, mund të përfshihen për shqyrtim dhe çështje të cilat nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
4. Prezantimi i projektaktit bëhet nga ministri propozues. Aktet, të cilat sipas ligjit propozohen nga Këshilli i Basenit Ujor ose Sekretariati Teknik, prezantohen nga Sekretari Kombëtar i Ujit.

5. Pas prezantimit, drejtuesi fton anëtarët të japin mendimet e tyre. Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten kofidenciale.

6. Projektakti mund të tërhiqet nga propozuesi në çdo kohë, deri para votimit të tij.

7. Pas përfundimit të diskutimit, drejtuesi fton anëtarët për votim.

8. Drejtuesi i mbledhjes mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përligj këtë veprim.

Neni 24
Konflikti i interesit

1. Dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore për konfliktin e interesit zbatohen për të gjithë anëtarët.

2. Anëtarët që kanë ndonjë pengesë ligjore nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe votimit.

Neni 25
Marrja e vendimit

1. Këshilli Kombëtar i Ujit merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës dhe ato të propozuara nga Kryetari, të cilat nuk janë parashikuar në rendin e ditës.

2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar.

3. Anëtarët, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë.

4. Vendimet merren me votim të hapur.

5. Drejtuesi i mbledhjes voton i fundit.

6. Në rastin kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e Kryetarit është vendimtare.

7. Kur rezultati i votimit është i barabartë dhe mbledhja drejtohet nga zëvendëskryeministri, vendimi shtyhet në mbledhjen pasardhëse të kryesuar nga Kryeministri.

Neni 26
Vendimi

Në përfundim të shqyrtimit të projektaktit, Këshilli Kombëtar i Ujit vendos:

a) miratimin e projektaktit të paraqitur;

b) miratimin e projektaktit me ndryshime;

c) shtyrjen e vendimit;

ç) rrëzimin e projektaktit.

Neni 27
Regjistrimi i mbledhjes

1. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Ujit regjistrohen në procesverbal me stenografi dhe në rrugë elektronike.

2. Procesverbali mbahet nga stenografët e Këshillit të Ministrave.

3. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe forma e rezultati i votimeve.

4. Procesverbali nënshkruhet nga stenografi, Sekretari Kombëtar i Ujit dhe drejtuesi i mbledhjes.

5. Në rastet kur mbledhja është e ndarë në seanca dhe drejtuesi e shikon të arsyeshme, procesverbali nënshkruhet pas përfundimit të seancës së fundit.

6. Procesverbali u paraqitet, përpara mbledhjes pasardhëse, anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Ujit, nëse një gjë e tillë kërkohet nga vetë ata. Në këtë rast, anëtarët kanë të drejtë të paraqesin vërejtje për përmbajtjen e tij, kur nuk është pasqyruar saktësisht qëndrimi i tyre në mbledhje.

Neni 28
Hyrja në fuqi e vendimit

1. Vendimi me karakter individual hyn në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

2. Vendimet me karakter normativ hyjnë në fuqi pas publikimit të tyre.

3. Lejet apo autorizimet për përdorim të burimit hyjnë në fuqi pas publikimit të tyre në Regjistrin e Licencave dhe Lejeve.

KREU VI
FORMALIZIMI, PUBLIKIMI, NJOFTIMI, ARKIVIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

Neni 29
Formalizimi, njoftimi, publikimi i vendimeve

1. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ujit formalizohet nga Sekretariati Teknik.

2. Vendimi nënshkruhet nga ministri propozues dhe drejtuesi i mbledhjes.

3. Vendimi për dhënie lejeje apo autorizimi për përdorimin e burimeve ujore nënshkruhet nga Sekretari Kombëtar i Ujit dhe drejtuesi i mbledhjes.

4. Vendimet e Këshillit Kombëtar të Ujit duhet të formalizohen brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes nga drejtuesi.

5. Sekretariati Teknik merr masa për njoftimin e institucioneve, organeve shtetërore, personave fizikë dhe juridikë, që kanë detyrime ose lidhje me përmbajtjen e vendimit.

6. Publikimi i vendimeve bëhet në faqen zyrtare të Sekretariatit Teknik dhe institucionit propozues të aktit, për të cilën është marrë vendimi përkatës.

Neni 30
Vula dhe protokolli

1. Këshilli Kombëtar i Ujit ka vulën zyrtare me të cilën identifikohet.

2. Vula ka formën dhe përmban elementet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare. Vula përmban shënimin identifikues "Këshilli Kombëtar i Ujit".

3. Vula administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo ruhet në kasafortë dhe përdoret vetëm nga punonjësit e ngarkuar me këtë detyrë në rastet e shoqërimit të dokumenteve origjinale, vulosjes së zarfeve etj.

4. Vula vendoset vetëm mbi firmën/ nënshkrimin e Kryetarit ose zëvendëskryeministrit. Përjashtimisht, vula vendoset dhe mbi firmën/ nënshkrimin e personave të autorizuar nga Kryetari.

5. Në rast të konstatimit të humbjes apo dëmtimit të vulës, vihet menjëherë në dijeni Kryetari dhe Sekretari Kombëtar i Ujit, ku ky i fundit merr masat për zëvendësimin e saj sipas procedurës ligjore. Përveç sa më sipër, në rastet e humbjes së vulës bëhet dhe denoncimi në organet kompetente.

6.Vula dhe protokolli administrohen nga punonjësi i protokollit të Këshillit të Ministrave.

Neni 31
Arkivimi dhe ruajtja e dokumentacionit

1. Vendimet, pas nënshkrimit të tyre nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Ujit ose nga drejtuesi i mbledhjes, ruhen dhe arkivohen në përputhje me legjislacionin në fushën e arkivave.

2. Sekretariati Teknik mban një regjistër, ku shënohen të gjitha aktet e miratuara në Këshillin Kombëtar të Ujit.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32

Projektaktet e miratuara nga Këshilli Kombëtar të Ujit, të cilat hyjnë në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, propozohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga ministri përgjegjës.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë